

Dokument politikash

*për uljen e mbipopullimit në Institucionet
e Ekzekutimit të Vendimeve Penale*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

Dokument politikash
për uljen e mbipopullimit në Institucionet
e Ekzekutimit të Vendimeve Penale



Nëntor 2015

Eksperte:

Dr. Evisa Kambellari

Grupi konsultativ i ekspertëve:

Alba Jorganxhi,

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Greg Riley-Smith,

Projekti i Binjakëzimit për Sistemin Penitenciar
dhe Shërbimin e Provës në Shqipëri

Blerta Doçi,

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve

ISBN: 978-92-9235-271-4

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument politikash janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

PËRMBAJTJA

Metodologjia	6
Hyrje	7

PJESA 1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1. Vështrim i përgjithshëm i situatës së sistemit penitenciar	9
1.1 Rezultate të monitorimeve	11
2. Pasojat e mbipopullimit në IEVP.....	12
2.1 Kostoja sociale	12
2.2 Kufizimi i mundësive për rehabilitimin e të dënuarve.....	13
2.3 Probleme me plotësimin e nevojave jetike.....	14
2.4 Efektet psikologjike te personat e privuar nga liria	14
2.5 Pakësimi i mundësive për klasifikimin e të dënuarve sipas nivelit të rrezikshmërisë.....	15

PJESA 2 SHKAQET E MBIPOPULLIMIT NË IEVP

1. Rritja e numrit të të paraburgosurve	17
1.1. Presionet politike për ashpërsimin e politikës penale.....	19
1.2 Përdorimi jo i përshtatshëm i masës së arrestit në burg.....	19
1.3 Vonesat në respektimin e afateve procedurale	21
2. Tendenca ndëshkuese në veprimtarinë e organeve të drejtësisë penale	22
3. Ashpërsimi i dënimeve.....	25
4. Zbatimi i ulët i disa prej alternativave të dënimit me burgim	27
5. Trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor	29
6. Rritja e kriminalitetit	30
6.1 Faktorët socio-ekonomikë	30

PJESA 3 KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

1. Në lidhje me orientimet e përgjithshme të politikës penale.....	33
2. Në lidhje me politikën penale ndaj të miturve.....	37
3. Në lidhje me zbatimin e alternativave të dënimit me burgim.....	39
4. Në lidhje me vlerësimin e rrezikshmërisë së të dënuarve dhe caktimin e llojit të dënimit apo vendit të vuajtjes së dënimit.....	42
5. Në lidhje me zbatimin e masës së mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor	45
6. Në lidhje me zbatimin e instrumenteve të drejtësisë restauruese	47
7. Në lidhje me ristrukturimin e sistemit penitenciar.....	48
8. Në lidhje me zbatimin e masave të sigurimit mbi lirinë personale.....	49
9. Në lidhje me adresimin e recidivizmit	50
Referenca	51

METODOLOGJIA

Me anë të këtij dokumenti synohet të evidentohen ato drejtime në zbatimin e politikave penale apo në praktikën e organeve të drejtësisë penale që ndikojnë në shtimin e fluksit të popullimit në burgje dhe në institucionet e paraburgimit, me qëllim propozimin e rekomandimeve mbi çështje që duhet të bëhen objekt i rivlerësimeve të mëtejshme nga aktorët përkatës.

Nëpërmjet studimit synohet të mblidhen të dhëna që do të evidentojnë edhe më qartë sfidat me të cilat përballet administrata e burgjeve në menaxhimin e kapaciteteve fizike dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve/paraburgosurve. Qëllimi final është projektimi i formave të nevojshme të ndërhyrjes për të arritur një kontroll të qëndrueshëm të popullsisë në institucionet e paraburgimit dhe vuajtjes së dënimeve penale.

Për realizimin e pjesës së dytë të këtij studimi është përdorur metoda sasiore. Vlerësimi është bazuar në studimin dhe interpretimin e të dhënave statistikore mbi tregues të ndryshëm si: normat e popullimit të sistemit të burgjeve në shtatë vitet e fundit, peshat që zë çdo kategori të burgosurish në raport me totalin e popullsisë aktuale të burgjeve, të dhënat që tregojnë ecurinë në vite të numrit të tëparaburgosurve, llojet e dënimeve të dhëna nga gjykatat etj.

Ky studim është mbështetur në të dhënat/informacionet e mbledhura nga:

- Takime me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), Shërbimit të Provës, strukturave të Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe me punonjës të administratës së burgjeve.
- Studimi i raporteve të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në lidhje me situatën e mbipopullimit në burgje, dhe raporteve të mekanizmave të tjerë monitorues të të drejtave të njeriut, raporteve të studimit mbi gjendjen e sistemit të drejtësisë penale në tërësi, etj.
- Vizita në ato Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) ku efektet e mbipopullimit në cilësinë e jetës së të dënuarve kanë qenë më të dukshme, dhe ku janë pasqyruar probleme në lidhje me respektimin e kushteve të sipërfaqes së banimit të të dënuarve, shfrytëzimin e ambienteve të përbashkëta, etj.
- Takimet e shpeshta të grupit të punës për të diskutuar mbi ecurinë dhe problematikat e studimit dhe propozimet për hapat e mëtejshëm të punës.

HYRJE

Mbipopullimi në burgje është një problem kompleks, i cili paraqet një shqetësim serioz për një numër qeverish në ditët e sotme. Ndër vite, popullsia e burgjeve në Shqipëri ka ardhur duke u rritur, çka ka përballur qeverinë me një sfidë në menaxhimin efikas të sistemit penitenciar. Shifrat zyrtare¹ tregojnë se numri total i personave të vendosur në institucionet e paraburgimit dhe të vuajtjes së dënimit, tejkalon ndjeshëm kapacitetin normal të këtyre institucioneve.

Mbipopullimi në burgje konsiderohet si një shqetësim serioz humanitar, pasi ai sjell rrjedhimisht kushte dënimi nën standardet e kërkuara², krijon probleme në plotësimin e nevojave bazike të të dënuarve dhe komprometon efektivitetin e programeve të rehabilitimit që zbatohen ndaj tyre. Në raportet e tyre më të fundit, aktorë të ndryshëm të sistemit të drejtësisë penale dhe mekanizmat monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut, kanë vënë në dukje seriozitetin e problemit dhe kanë bërë thirrje mbi nevojën për trajtimin e shkelësve të ligjit me masa të ndryshme nga ato të ndalimit në burg.

Pikësëpari, ky dokument paraqet një panoramë të përgjithshme të gjendjes aktuale të sistemit penitenciar, me fokus të veçantë në paraqitjen e problemeve kryesore me të cilat përballet administrata e burgjeve në terma të menaxhimit efektiv të institucioneve të ndalimit/dënimit dhe respektimit të të drejtave themelore të të burgosurve.

Këtu analizohen disa nga problemet kryesore të politikës ndëshkimore si dhe në funksionimin e sistemit të drejtësisë penale, që kanë pasur ndikim të konsiderueshëm në situatën e mbipopullimit në burgje.

Pjesa e fundit përmban një përmbledhje të gjetjeve kryesore të punimit, si dhe rekomandime mbi çështjet që duhet të jenë objekt shqyrtimi apo rivlerësimi nga ana e politikëbërësit me qëllim adresimin e problemit të mbipopullimit në burgje. Theks i veçantë është vendosur mbi nevojën e marrjes në konsideratë të përjasjeve të reja për trajtimin e shkelësve të ligjit si: racionalizimi i politikës ndëshkimore, zgjerimi i aplikimit të dënimeve alternative, rritja e roleve të komuniteteve në kontrollin e personave me sjellje deviante, ristrukturimi i sistemit penitenciar, zgjerimi i fushës së zbatimit të drejtësisë restauruese në çështjet penale, si dhe ndërmarrja e reformave strukturore për të parandaluar faktorët që motivojnë sjelljen kriminale.

1 Ky konstatim është nxjerrë nga studimi i të dhënave statistikore të DPB-së për vitet 2014, 2015.

2 United Nations Office on Drugs And Crime (2013). Handbook on strategies to reduce overcrowding in prisons. *Foreword by the International Committee of the Red Cross (ICRC)*, <http://www.unodc.org/> [20 Maj 2015].

PJESA I

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM


1. Vështrim i përgjithshëm i situatës së sistemit penitenciar

Në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë aktualisht 23 IEVP të cilat shërbejnë si burgje ose qendra paraburgimi, duke përfshirë edhe një Institut për të miturit në Kavajë, si dhe një institucion të veçantë në Krujë për personat e vendosur nën masën e mjekimit të detyruar, personat me probleme të shëndetit mendor dhe të moshuarit³.

Shifrat zyrtare tregojnë se popullsia e burgjeve në vitet e fundit ka pësuar një rritje të vazhdueshme, duke tejkaluar ndjeshëm kapacitetin normal të këtyre institucioneve. Mbipopullimi në burgje paraqet tashmë një shqetësim serioz për administratën e burgjeve, e cila duhet të sigurojë strehim të përshtatshëm dhe të përmbushë nevojat bazike të jetesës për një fluks gjithnjë e më të madh të burgosurish.

Të dhënat në grafikun e mëposhtëm tregojnë se si ka ecur trendi i popullsisë në burgje në tetë vitet e fundit.

Figura 1.1 Trendi i popullsisë së burgjeve 2008-2015⁴




Rritja e popullsisë së burgjeve është shoqëruar me probleme gjithnjë e më të theksuara për sa i takon shfrytëzimit të kapacitetit fizik të IEVP-ve kundrejt fluksit të shtuar të të burgosurve.

3 Dokumenti “Fact Finding for Institutional Self Assessment, Sector: Fundamental Rights, Penitentiary System”, f. 1., Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, 2015.


4 Të dhënat për vitin 2015 i referohen statistikave të hartuara nga DPB për gjendjen e të burgosurve në muajin gusht 2015.

Figura 1.2 Niveli i popullimit në raport me kapacitetin e IEVP-së 2008-2015



Prej vitit 2012 niveli i mbipopullimit ka pësuar rritje të vazhdueshme, duke arritur pikën e tij më kritike në vitin 2014. Në vitin 2014 mbipopullimi në IEVP ishte në shifrën 30% mbi kapacitetin e lejuar, në krahasim me 20% në vitin 2013. Të dhënat për situatën e mbipopullimit deri në gusht të vitit 2015 tregojnë se gjendja vazhdon të mbetet tepër problematike, me një mbipopullim prej 22% mbi kapacitetin.

Figura 1.3 Niveli i mbipopullimit 2008-2015



Edhe pse të dhënat flasin qartë për një tendencë në rritje të popullsisë së burgjeve, ende nuk ka një vlerësim të gjithanshëm për identifikimin e faktorëve që ndikojnë në rritjen e normave të dënimit me burg apo paraburgimit. Burime të veçanta tregojnë se problemi është rezultat i ndërveprimit të një kompleksiteti faktorësh, të cilët kanë të bëjnë si me çështje të politikës penale ashtu dhe me probleme të funksionimit eficient të sistemit të drejtësisë penale. Të dhënat e viteve të fundit tregojnë se problemi i mbipopullimit në burgje është kthyer në një çështje alarmante. Në këto kushte, janë shumë të nevojshme ndërhyrjet e mirëstudiuara për të parandaluar flukse edhe më të larta të burgosurish dhe të paraburgosurish në të ardhmen.

1.1 Rezultate të monitorimeve

Mekanizmat monitorues të respektimit të të drejtave të njeriut kanë pohuar njëzëri se problemi kryesor me të cilin përballet sistemi penitenciar në ditët e sotme është mbipopullimi. Nga misionet e monitorimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) për vitin 2014 ka rezultuar se ka problematika të qenësishme sa i takon kushteve të jetesës në institucionet e paraburgimit dhe burgjet e vendit, të ndikuara këto nga niveli i lartë i mbipopullimit, si dhe nga mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme për ta përballuar këtë situatë⁵. Raporti vinte në dukje se, në pamundësi për të akomoduar të gjithë të burgosurit, drejtuesit e institucioneve të paraburgimit/burgjeve i kishin kthyer mjediset e tjera të punës në mjedise strehimi për të burgosurit. Gjithashtu, shumë të burgosur nuk kishin krevat personal; ata shpesh flinin përtokë, në ndonjë rast edhe pa dyshek (vetëm duke vendosur batanijet përtokë). Gjithashtu janë vërejtur dhe probleme me ajrimin dhe kushtet higjienike.⁶

Në janar 2015, Avokati i Popullit, me anë të një raporti zyrtar shprehu shqetësimin e tij serioz mbi situatën e mbipopullimit në burgje dhe kërkoi nga autoritetet përkatëse shtetërore të marrin masa të përshtatshme për zgjidhjen e problemit. Disa nga pikat e raportit flasin për një gjendje kritike që grupi monitorues ndeshi në disa prej IEVP-ve të monitoruara, veçanërisht në qendrat e paraburgimit. Disa nga shkeljet kryesore kishin të bënin me sipërfaqen e jetesës dhe pasojat e tjera që mungesa e hapësirave të nevojshme shkakton tek të burgosurit.

Në pjesën më të madhe të IEVP-ve konstatohej se numri i të dënuarve/paraburgosurve tejkalonte ndjeshëm kapacitetin zyrtar, dhe në disa prej tyre gjendja paraqitej akoma më kritike duke shkuar deri në dyfishin e numrit normal të të burgosurve që mund të mbajnë këto institucione, sikurse ishte rasti i IEVP-së «Jordan Misja» (313), Elbasan, Fushë-Krujë, Drenovë etj.⁷ Në paraburgimin «Jordan Misja» sipërfaqja personale e jetesës për të burgosur arrinte në 2.2m², ndërkohë që standardi minimal është 6m² për person⁸. Në këtë qendër, fjetja me dyshek në tokë ishte e pranishme pothuajse në çdo dhomë. Problemi i fjetjes përtokë ishte evident edhe në institucione të tjera të monitoruara, si për shembull në IEVP Drenovë dhe IEVP Elbasan⁹.

Kthimi i ambienteve të projektuara për organizimin e aktiviteteve, në dhoma banimi,

5 Shih: "Raport mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut të Personave të Privuar nga Liria në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë dhe Institucionet e Paraburgimit dhe të Ekzekutimit të Vendimeve Penale", Komiteti Shqiptar të Helsinkit, Tiranë 2014, f.9.

6 Po aty, fq. 38-39.

7 Raport i Avokatit të Popullit, dt. 06.01.2015, Mbi situatën e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, fq. 4-7.

8 Shih: Komentari i Rregullit 18 i Rregullave Evropiane të Burgjeve (European Prison Rules), ku thuhet se Komiteti për Parandalimin e Torturës konsideron se sipërfaqja minimale e qelisë së burgut duhet të jetë 6 m², dhe në rast të akomodimit të përbashkët të disa të burgosurve në një qeli, sipërfaqja minimale për të burgosur nuk duhet të jetë më pak se 4 m². <http://www.coe.int>

9 Në një rast në IEVP Rrogozhinë, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) konstatoi se një dhomë e përmasave 6x7x2.50m banohej prej muajsh nga 21 të paraburgosur. Në këtë dhomë 14 veta flinin në 7 shtretër me dy kate, 5 të tjerë flinin me dyshek në tokë dhe dy të paraburgosur të tjerë flinin me turne apo dy veta në një krevat. Shih më sipër: Raport i Avokatit të Popullit, fq. 5-6.

për shkak të mbipopullimit, ka kufizuar mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve në një numër të IEVP-ve, si në Burrel, Korçë, Durrës, Lezhë, Tepelenë, Jordan Misja, Mine Peza, Kosovë-Lushnje etj.¹⁰

Detyrimet ligjore për ngritjen e institucioneve mjekësore të posaçme, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” nuk kanë gjetur zbatim. Trajtimi i kësaj kategorie të dënuarish në IEVP vijon të mbetet i paligjshëm, duke ndikuar edhe në problemin e mbipopullimit.

Mbajtja e tyre në IEVP Krujë dhe në spitalin e burgjeve është denoncuar vazhdimisht si një shkelje flagrante e ligjit dhe e standardeve ndërkombëtare, që sjell trajtim diskriminues të këtyre pacientëve dhe përkeqësim të gjendjes së tyre shëndetësore¹¹.

2. *Pasoja e mbipopullimit në IEVP*

2.1 Kostoja sociale

Në një vështrim makro, rritja e popullsisë në IEVP përbën një barrë të rëndë për financat publike. Çdo vit, qeveria shpenzon qindra miliona lekë për të mbështetur administrimin normal të sistemit penitenciar. Si rrjedhim, mbipopullimi shkakton edhe kosto të paevitueshme sociale, pasi një pjesë gjithnjë e më e madhe fondesh publike do të përdoren për administrimin e burgjeve, dhe jo për financimin e projekteve që shërbejnë për plotësimin e nevojave të ndryshme të jetesës në komunitet.


Fondet që shkojnë për plotësimin e nevojave në rritje të sistemit penitenciar, si pasojë e mbipopullimit, mund të përdoren për zgjerimin e infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore të angazhuar në zbatimin e alternativave të dënimit me burg.

Mbipopullimi shkakton rrjedhimisht edhe një degradim më të shpejtë të ndërtesave, duke ulur ndjeshëm vlerën e investimeve të kryera rishtazi për përmirësimin e hapësirave të IEVP-ve, dhe duke sjellë nevojën për shpenzime të tjera që shtojnë kostot e mbajtjes dhe administrimit të këtyre institucioneve.

Në Figurën 1.4 bëhet një pasqyrim i kostove totale faktike të sistemit penitenciar për vitet 2010-2014, nga ku vihet re se shpenzimet kanë pësuar një rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2014.

10 Aktiviteti i Avokatit të Popullit të Shqipërisë në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Raporti i Posaçëm, 2014, f.15

11 Shih më sipër: “Raport mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut...”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014, f.55.



Ndërkohë, në Tabelën 1.1 paraqiten shpenzimet ditore për të dënuarit sipas kategorive. Kostoja vjetore për secilën kategori arrin në shifra tepër të larta në kushtet e një popullsie burgjesh që pëson rritje graduale.

Tabela 1.1

Kategoria	Shpenzime Euro/ditë/ 1 person
Të gjithë	14.21 Euro
Të p/burgosur	14.63 Euro
Të dënuar	12.30 Euro
Të sëmurë	46.26 Euro
Të mitur	17.54 Euro

2.2 Kufizimi i mundësive për rehabilitimin e të dënuarve

Efektiviteti i proceseve të riintegritit social duket se cenohet në mënyrë serioze në një IEVP të mbipopulluar. Procesi i riintegritit social i referohet ndihmës me anë të aktiviteteve të përbashkëta që kontribuojnë në zhvillimin moral, edukativ dhe profesional të të burgosurve, si dhe adresimit të nevojave të veçanta të tyre, si kushtet psikologjike, varësia ndaj drogës, menaxhimi i zemërimit, etj.

Në raportin e tij të fundit mbi gjendjen e sistemit penitenciar, Avokati i Popullit raportoi se mbipopullimi ka çuar në reduktimin e hapësirave fizike për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përbashkëta. Për më tepër, duke u përballuar me një numër më të madh të dënuarish, administrata e burgut vendoset në pamundësi për të përmbushur në mënyrë të kënaqshme kërkesat për hartimin dhe zhvillimin e programeve rehabilituese të individualizuara në përputhje me veçoritë e personalitetit të secilit të burgosur.

Kufizimet në hapësirat fizike të nevojshme dhe në burimet njerëzore përbëjnë sfida për zbatimin efektiv të programeve të përgjithshme dhe individuale të rehabilitimit¹². Numri i arsimtarëve dhe punonjësve psiko-socialë sipas organikës aktuale është tepër i ulët për të plotësuar efektivisht nevojat e të burgosurve për programe edukuese, rekreative apo asistencë dhe këshillim psiko-social. Konkretisht, në total numërohen 27 psikologë, 29 punonjës socialë dhe 60 arsimtarë, ndërkohë që numri i të burgosurve me të cilët duhet të punohet tejkalon mundësitë reale të këtyre profesionistëve për ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Sipas DPB-së, mbipopullimi sjell pasoja edhe në drejtim të transferimit të të dënuarve nga paraburgimet dhe komisariatet në institucione më pak të mbipopulluara, larg vendbanimit të familjarëve të tyre¹³. Transferimi në këto institucione pakëson mundësitë e vizitave të shpeshta (të rregullta) nga kontakte të jashtme. Në mënyrë të veçantë, shkëputja prej lidhjeve familjare mund të influencojë negativisht rehabilitimin e të dënuarve. Kjo pasi studimet tregojnë se të dënuarit ndaj të cilëve tregohet një interes aktiv prej familjarëve gjatë kohës së dënimit, kanë mundësi më të mëdha për t'u riintegruar në shoqëri dhe norma më të ulëta recidivizmi¹⁴.

2.3 *Probleme me plotësimin e nevojave jetike*

Një vlerësim i situatës tregon se mbipopullimi në burgje zvogëlon mundësitë e administratës së burgut për përmbushjen e nevojave bazike jetësore të të dënuarve. Ky fenomen sjell pasoja në drejtim të reduktimit të hapësirave fizike personale, të kohës së ajrimit, trajtimit mjekësor, plotësimin të kushteve të nevojshme higjienike etj., duke çuar në mënyrë të pashmangshme në shkelje të rregullave dhe standardeve për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve.

2.4 *Efektet psikologjike tek të dënuarit/paraburgosurit*

Mbipopullimi luan një rol jo të vogël në rritjen e tensionit dhe presioneve psikologjike tek personat e privuar nga liria. Studimet tregojnë se ai krijon një gjendje konkurrence midis të dënuarve në lidhje me përdorimin e burimeve të kufizuara, bëhet shkak për sjellje agresive mes tyre ose kundrejt administratës së burgut, ndikon në rritjen e normave të vetëvrasjes, si dhe të ngacmimit (vënies në lojë), dhe viktimizimit të personave më vulnerabël¹⁵.

Nivelet e larta të stresit mund të shkaktojnë probleme emocionale dhe psikologjike të

12 United Nations Office on Drugs And Crime, *Custodial and Non-Custodial Measures, Social Reintegration*, (2006),1, <https://www.unodc.org>, [23.06.2015].

13 Analizë vjetore e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, 2013.

14 Shih: Marion Vacharet, *Private Family Visits in Canada, Between Rehabilitation and Stricter Control: Portrait of a System*, <https://champpenal.revues.org/2322> [28 maj 2015].

15 *The Effects of Prison Overcrowding*. John Howard Society of Alberta (1996). <http://www.johnhoward.ab.ca/pub/C42.htm> [20 qershor 2015].

një natyre kronike tek të dënuarit¹⁶, të cilat vazhdojnë të jenë të pranishme edhe pas daljes nga burgu. Ndërkohë, studiuesit janë shprehur se efektet psikologjike negative gjatë vuajtjes së dënimit, mund të ndikojnë në rritjen e normave të recidivizmit¹⁷. Ish-të dënuarit rikthehen në shoqëri me një barrë psikologjike të shkaktuar nga privimi i lirisë, e cila mund të përbëjë një pengesë reale për socializimin e tyre normal dhe riintegrimin në shoqëri. Problemet psikologjike, së bashku me faktorë të tjerë risku, sikurse stigmatizimi ose mungesa e perspektivave të punësimit, mund të kthehen në stimuj të rrezikshëm kriminalë.

2.5 *Pakësimi i mundësive për klasifikimin e të dënuarve sipas nivelit të rrezikshmërisë*

Burgjet e mbipopulluara mund të kthehen në 'qendra' të sofistikimit të mëtejshëm kriminal, pasi mundësitë për veçimin e të dënuarve sipas rrezikshmërisë, janë të vogla. Të dënuarit për vepra penale më të lehta, ndajnë të njëjtin ambient me personat që përbëjnë rrezikshmëri, dhe si rrjedhim, janë nën ndikimin e ndjeshëm të modeleve kriminale të të menduarit dhe sjelljes¹⁸.

16 Shih: Robert.M Freeman, *Correctional Organization and Management. Public Policy Challenges, Behavior, and Structure* (Woburn: Butterworth-Heinemann,1999), 88.

17 Shih: Joan Petersilia and Kevin R. Reitz, *The Oxford Handbook of Sentencing and Corrections* (Oxford: Oxford University Press, 2012), 599.

18 D.A. Andrews and James Bonta, *The Psychology of Criminal Conduct* (Oxon: Routledge, 2015), 435.



PJESA II


SHKAQET E MBIPOPULLIMIT NË IEVP

1. Rritja e numrit të të paraburgosurve

Presionet politike për ashpërsimin e politikës ndëshkuese si dhe disa probleme në praktikën e funksionimit të organeve të drejtësisë penale kanë luajtur një rol jo të vogël në rritjen e popullsisë në institucionet e paraburgimit.

Rritja e numrit të të paraburgosurve rezulton të jetë një nga shkaqet kryesore të mbipopullimit të burgjeve, veçanërisht gjatë tre viteve të fundit. Nga studimi i të dhënave zyrtare mbi nivelin e mbipopullimit në qendrat e paraburgimit në shtatë vitet e fundit, vihet re një tejkalim gjithnjë e në rritje i kapacitetit normal të këtyre institucioneve. Në figurën 2.1 duket qartë se niveli i mbipopullimit ka arritur shifra tepër të larta veçanërisht në vitet 2013-2015.

Figura 2.1 Niveli i mbipopullimit në institucionet e paraburgimit (%)




Të dhënat në Tabelën 2.1 japin një panoramë të përgjithshme të ecures së popullsisë në burgje dhe në qendra paraburgimi gjatë shtatë viteve të fundit, duke pasqyruar edhe ndikimin e këtyre lëvizjeve në situatën e mbipopullimit në sistemin penitenciar në tërësi.

Tabela 2.1 Popullsia e burgjeve (2009-2015)¹⁹

Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015 gusht)
Popullsia e burgjeve në total	4667	4657	4659	4618	5450	5897	6110
Popullsia totale për 100 000 banorë	158	159	160	159	188	203	211
Të dënuar	3039	2772	2809	2862	3139	3183	3188
Të dënuar për 100 000 banorë	103	94	96	99	108	110	110
Të paraburgosur	1628	1885	1850	1756	2311	2714	2922
Të paraburgosur për 100 000 banorë	55	65	64	60	80	93	101
Kapaciteti	4380	4341	4417	4417	4537	4537	4999
Mbipopullimi total	287	316	242	201	913	1360	1111
Norma e rritjes/zbritjes së numrit të të dënuarve		-267	+37	+53	+277	+44	
Norma e rritjes / zbritjes së numrit të të paraburgosurve		+257	-35	-94	+555	+403	
Ndryshimet në nivelin e mbipopullimit		+29	-74	-41	+712	+447	

Figura 2.2 Trendi i popullsisë së burgjeve për 100 000 banorë



Të dhënat në tabelën më sipër si dhe në Figurën 2.2 tregojnë se si ka ardhur duke u zvogëluar hendeku midis numrit të të dënuarve dhe të paraburgosurve ndër vite. Norma e popullsisë në qendra paraburgimi ka pësuar rritje të konsiderueshme prej vitit 2013, duke arritur nivelin më kritik të saj në gusht 2015, me 101 të paraburgosur për 100 000 banorë.

Gjithashtu, vërehet se norma e mbipopullimit ndikohet në masë të madhe nga tendencat që ndjek norma e popullsisë në qendrat e paraburgimit, duke pësuar rritje të larta apo zbritje, në varësi të ndryshimeve të kësaj norme. Në Figurë duket qartë se si trajektorja e numrit total të popullsisë së burgjeve dhe trajektorja e numrit të të paraburgosurve ndër vite ndjekin pak a shumë të njëjtën linjë zhvillimi.

19 Burimi i të dhënave: Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve.

1.1. Presionet politike për ashpërsimin e politikës penale

Gjatë vitit 2014 Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ka vënë në dukje se pjesa më e madhe e të paraburgosurve të vendosur në qelitë e mbipopulluara janë aty si pasojë e politikave të fundit të qeverisë për ashpërsimin e ndëshkimit penal për vjedhësit e energjisë elektrike dhe për autorët e veprave penale në fushën e qarkullimit rrugor. Drejtuesja e MKPT-së, ka kërkuar që qeveria të rivlerësojë politikat e saj, dhe që sistemi i drejtësisë të mos përdorë masën e sigurisë arrest në burg për vepra penale të lehta²⁰. Në bazë të regjistrave të inspektuar nga MKPT-ja në komisaritet e policisë ka rezultuar se pjesa më e madhe e personave në dhomat e sigurisë, por edhe ata të transferuar, janë ndaluar/arrestuar për vepra penale të tilla si: drejtim mjete pa leje drejtimi (këtu pjesa më e madhe e personave të intervistuar ishin të mitur); drejtim i automjetit në gjendje të dehur; lidhje e paligjshme e energjisë elektrike; dhunë në familje, etj. Shtimi i numrit të personave të ndaluar/arrestuar për tre veprat e para, tregon se një faktor tepër i rëndësishëm për mbipopullimin rezulton të jetë ashpërsimi i politikës penale²¹.

Numri i të paraburgosurve vazhdon të ketë një tendencë në rritje gjatë vitit 2015. Në muajin gusht 2015, mbipopullimi në institucionet e paraburgimit arriti në nivele kritike me një nivel mbipopullimi 75% mbi kapacitetin normal. Nga studimi i të dhënave zyrtare rezulton se në këtë muaj numri i të paraburgosurve përbën 47.8% të totalit të popullsisë së burgjeve.

1.2 Përdorimi jo i përshtatshëm i masës së arrestit në burg

Mekanizmat monitorues të të drejtave të njeriut kanë shprehur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimin se zbatimi me përparësi i masës së sigurimit “arrest në burg” nga ana e gjykatave është një nga shkaqet kryesore të mbipopullimit në institucionet e paraburgimit²². Sipas tyre, kërkesat për zbatimin e masës së arrestit në burg nuk justifikohen gjithmonë nga nevoja urgjente të administrimit të drejtësisë penale. Avokati i Popullit është shprehur se privimi i lirisë nëpërmjet dhënies së masës së sigurimit arrest në burg, duhet konsideruar jo si opsioni kryesor, por si masa më e rëndë që jepet vetëm në rastet e parashikuara në nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale²³. Ky institucion ka rikujtuar se në caktimin e kësaj mase duhet mbajtur parasysh qëndrimi i Gjykatës së Lartë (i shprehur në vendimin nr. 8, datë 19.1.2001 dhe nr. 46, datë 28.1.1999 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë) ku përcaktohet se: “...për caktimin si masë siguri arrest në burg për të pandehurin, duhet të ekzistojë një dyshim i bazuar se i pandehuri mund t'i shmanget gjyqimit

20 Erebara, Gj. (2015). *Albania Ombudsman Slams Jail Overcrowding*. <http://www.balkaninsight.com/>, [10 qershor 2015].

21 Shih: Aktiviteti i Avokatit të Popullit të Shqipërisë në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Raporti i Posaçëm, 2014, f.247.

22 Shih: “Raport mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut të Personave të Privuar nga Liria në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë dhe Institucionet e Paraburgimit dhe të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014, f.8,36, <http://ahc.org.al/> f.8, 36 [5 korrik 2015].


23 Report of the Albanian People’s Advocate “*On the situation of overcrowding in penitentiary institutions*”, January 6, 2015.

apo ekzekutimit të vendimit, apo se ai ka rrezik të kryejë ndonjë vepër penale tjetër të rëndë apo të të njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar...”si dhe “...Në caktimin e masave të sigurimit gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës prej tyre me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret...”²⁴.

Në praktikën e kohëve të fundit kjo masë është përdorur gjerësisht edhe për vepra penale të cilat nuk paraqesin një nivel rrezikshmërie që i përgjigjet kufizimit me masë arresti në burg, si p.sh. vjedhja e energjisë elektrike, drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi, etj. Akoma më shqetësues paraqitet aplikimi që gjejnë zakonisht këto masa për autorët e mitur. Raportet e studimit mbi sistemin e drejtësisë penale vënë në dukje se mbetet ende për t’u trajtuar çështja e përdorimit të tepruar të paraburgimit, i cili nuk duhet parë si zgjidhja e duhur apo si masë standarde²⁵.

Nga studimi i të dhënave statistikore vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme lidhur me masat e sigurimit për subjektet e dërguar për gjykim, rezulton që arresti në burg të jetë masa më e përdorur në praktikën e punës së organit të prokurorisë, duke u zbatuar në më shumë se 90% të rasteve.

Figura 2.3 Masat e sigurimit për subjektet e dërguar për gjykim 2012-2013²⁶



Një trend i tillë duket të jetë mbizotërues edhe në vitin 2014. Kështu nga 120 persona të mbartur në procedimet ende në hetim për vitin 2014, 100 prej tyre (ose 83%) janë të vendosur në masë arresti në burg²⁷.

24 Po aty.

25 Burimi: Raporti i studimit të fizibilitetit për programin e reformës në sektorin e drejtësisë në Shqipëri, përgatitur nga Grupi i Punës i Zinxhirit të Drejtësisë (Policia Suedeze, Autoriteti Suedezi i Prokurorisë, Administrata Suedeze e Gjykatave Kombëtare dhe Shërbimi Suedezi i Burgjeve dhe Provës), 2015, f. 31.

26 Burimi i të dhënave: Raporte të Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitet 2012, 2013. <http://www.pp.gov.al/>

27 Raport i Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitet 2013.

1.3 Vonesat në respektimin e afateve procedurale

Në raportet e tij vjetore për monitorimin e situatës së respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, KShH është shprehur se zgjatja e afateve të paraburgimit vazhdon të jetë problem prezent për sa i takon respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur. Zgjatja e afateve të paraburgimit është kryesisht pasojë e hetimeve të gjata ose të ngadalta si dhe e zvarritjes së proceseve gjyqësore në gjykatat penale.

Shtyrja e seancave ndikon ndjeshëm në zgjatjen e afateve të paraburgimit, në rastet kur i pandehuri në zbatim të kërkesës së prokurorisë është vendosur në masën e arrestit në burg. Ndër arsyt kryesore për shtyrjen e seancave evidentohen mungesa e adresave të palëve (çka bën të vështirë informimin e tyre), mungesa e palëve, avokatëve ose e prokurorit²⁸. Në studimin e tij më të fundit, KShH vëren se janë palët, kryesisht kërkuesit, ato që shtynë procesin me kërkesa për shtyrjen e gjykimit²⁹. Por, problematike mbetet dhe mungesa e prokurorëve në seancë gjyqësore pa i paraqitur gjykatës asnjë kërkesë justifikuese. Këto probleme kanë qenë edhe më të theksuara në rastin e femrave të paraburgosura, ku në shumë raste është konstatuar një kohë e gjatë e qëndrimit të grave në pritje të vendimit të formës së prerë nga gjykata. Koha e qëndrimit të tyre në paraburgim varionte nga 14 muaj deri në dy vjet³⁰.

Zgjatja e proceseve gjyqësore është një faktor që mund të ndikojë në situatën e mbipopullimit. Edhe pse të dhënat statistikore tregojnë se numri i çështjeve penale të përfunduara ka pësuar rritje të ndjeshme³¹, numri i çështjeve që presin të gjykohen në gjykatat penale vazhdon të mbetet i lartë.

Të dhënat në Figurën 2.3 tregojnë se numri i çështjeve të papërfunduara paraqet një tendencë në rritje gjatë tre viteve të fundit. Zgjatja e procesit gjyqësor ndikon në mënyrë të pashmangshme në afatet e paraburgimit të personave ndaj të cilëve është caktuar një masë sigurimi për kufizimin e lirisë personale, duke zgjatur kohën e qëndrimit të tyre në IEVP.


28 Shih më sipër: Raporti i studimit të fizibilitetit... Grupi i Punës i Zinxhirit të Drejtësisë, 2015, f.15.

29 Shih: 'Raport studimor për vendimet e prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale dhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve penale', Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014. f. 49. <http://ahc.org.al/>, aksesuar 26 shtator 2015.

30 Shih më sipër: "Raport mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut....", Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014, f.13.

31 Sipas të dhënave të Vjetarit Statistikor 2014, volumi i punës ka pësuar rritje të çështjeve penale të përfunduara, me 5742 çështje më shumë se në vitin 2013, me 4640 çështje më shumë se në vitin 2012 dhe 4997 më shumë se sa në vitin 2011.

Figura 2.3 Numri i çështjeve gjyqësore të papërfunduara 2007-2014




Një tjetër problem që evidentohet për sa i takon respektimit të afateve procedurale ndaj personave të paraburgosur është edhe vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore. Moszbardhja e vendimeve gjyqësore brenda afatit ligjor sjell vonesa në nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit nga prokuroria, duke shkaktuar shpeshherë cenim të rëndë të të drejtave të njeriut. P.sh., nga monitorimet në gjykatat e Tiranës dhe Durrësit ka rezultuar se në më shumë se gjysmat e vendimeve për ekzekutim të menjëhershëm, urdhrat e ekzekutimit janë lëshuar nga organi i prokurorisë me dy deri në katër ditë vonesë³².

2. Tendanca ndëshkuese në veprimtarinë e organeve të drejtësisë penale

a. Veprimtaria e prokurorisë

Nga studimi i të dhënave statistikore mbi llojet e dënimeve të kërkuara nga prokuroria, vihet re se në vitet 2012-2013 ka një ulje të ndjeshme të dënimit me gjobë të kërkuar nga prokuroria dhe dhënë nga gjykata.

Figura 2.2 Të dhëna mbi zbatimin e dënimit me gjobë 2009 – 2013³³



32 Shih më sipër: 'Raport studimor për vendimet e prokurorisë për mosfillimin ...', Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014, f. 80.

33 Të dhënat janë marrë nga Raporti vjetor i Prokurorisë të Përgjithshme mbi Gjendjen e Kriminalitetit 2013, f.209, <http://www.pp.gov.al/> [30 gusht 2015].


Të dhënat statistikore tregojnë për ulje prej 36.49% të dënimeve me gjobë të kërkuara nga prokurorët gjatë vitit 2013 në krahasim me vitin 2012. Gjithashtu gjatë vitit 2012 ka një ulje prej 19.86% në krahasim me vitin 2011. E njëjta tendencë vihet re edhe në vendimet e dhëna nga gjykata për dënimin me gjobë. Në vitin 2013 ka një ulje prej 38.86% të këtij dënimi në krahasim me vitin 2012; dhe në vitin 2012 ka një ulje prej 19.16% në krahasim me vitin 2010.

b. Dënime të dhëna nga gjykata³⁴

Të dhënat statistikore tregojnë se në vitet 2012 dhe 2013 kemi një ulje të konsiderueshme të dhënies së dënimeve me gjobë, respektivisht prej 18.8% dhe 24.30%, në krahasim me vitin paraardhës. Në vitin 2014 vihet re një rritje e vogël e zbatimit të dënimit me gjobe prej 1.4% në krahasim me vitin paraardhës, megjithatë, dënimi me burgim dominon ndjeshëm në praktikën e ndëshkimit të gjykatave.

Nëse analizojmë politikën e përgjithshme ndëshkuese të gjykatës në pesë vitet e fundit, vëmë re se aplikimi i dënimit me gjobë nuk ka ecur në mënyrë përpjesëtimore me rritjen e numrit të të dënuarve, ndërkohë që nga figura duket qartë se dënimi me burgim kë pësuar një rritje përpjesëtimore ndër vite, çka ka thelluar edhe më tej diferencën midis numrit të dënimeve me burg dhe dënimeveme gjobë të dhënë nga gjykata.

Figura 2.3 Praktika e dënimit nga gjykatat 2009-2014³⁵



Të dhënat statistikore tregojnë për një ulje prej 23.9% të dënimeve të larta nga 10-25 vjet burg, të dhëna nga gjykata për vitin 2012 në krahasim me vitin 2011. Ndërkohë, këto dënime kanë pësuar një rritje prej 28.9% në vitin 2013. Të dhënat e fundit tregojnë një prirje të lehtë për rritjen e zbatimit të dënimit me burgim nga 10 deri në 25 vjet.

34 Të dhënat janë marrë nga studimi i Vjetarëve Statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë.

35 Burimi i të dhënave: Vjetarët Statistikorë të Ministrisë së Drejtësisë.


Tabela 2.3 Numri total i dënimeve sipas llojit 2009-2010

	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Dënim me gjobë	2949	3270	3838	3114	2357	2694
Dënim me burg (5 ditë-2 vjet)	3340	3671	4234	4386	4889	9442
Dënim me burg (2-5 vjet)	577	558	630	707	812	935
Dënim me burg (5-10 vjet)	292	241	259	367	346	355
Dënim me burg (10-25 vjet)	157	149	155	118	166	174
Dënim me burg (25-35 vjet)	-	-	-	-	-	5
Dënim me burgim të përjetshëm	10	7	13	11	8	13

1.1 Lidhur me të dënuarit e mitur

Për të miturit autorë të veprave penale, dënimi që zbatohet zakonisht është dënimi me burgim, ndërkohë që prirja për zbatimin e dënimit me gjobë ka ardhur duke u ulur në vitet 2013 dhe 2014.

Figura 2.4 Praktika e dënimit të të miturve 2010-2014



Sikurse mund të vihet re nga studimi i të dhënave në Tab. 2.4, trendi i dënimeve të dhëna ndaj të miturve është dënimi me burg deri në dy vjet.

Tabela 2.4 Llojet e dënimeve të dhëna për të miturit³⁶

Dënimi	2010	2011	2012	2013	2014
me gjobë	26	24	45	33	13
deri në 2 vjet burg	539	553	724	525	481
2-5 vjet burg	22	24	51	25	44
5-10 vjet burg	4	4	11	6	7
10-25 vjet burg	1	6	1	0	0


Efiçenca e dënimit me burg deri në dy vjet paraqitet problematike për sa i takon përmbushjes së objektivave për rehabilitimin e shkelësve jo të rrezikshëm. Orientimi

36 Burimi: Të dhëna statistikore nga Vjetarët e Ministrisë së Drejtësisë ndër vite.

drejt dënimeve të shkurtra me burg për të miturit, krahas rëndimit të gjendjes së mbipopullimit mund të influencojë negativisht në përpjekjet për rimodelimin e sjelljes së tyre. Për këtë kategori shkelësish të mitur do të ishte mirë që të punohej më tej për aplikimin e dënimeve alternative.

Ndërkohë, zbatimi i dënimeve alternative për të dënuarit e mitur në tërësi ka ardhur duke u rritur prej vitit 2013.

Figura 2.5 Numri i të miturve të vendosur në dënime alternative (2009-2014)



3. Ashpërsimi i dënimeve

Në kuadër të ndryshimeve që pësoi Kodi Penal në vitin 2013, një numër veprash penale, për të cilat mund të jepej në mënyrë alternative dënimi me gjobë ose me burg, dënohen tashmë vetëm me burg³⁷. Në disa raste, politika e ashpër e ndëshkimit e ndjekur nga ligjvënësi duket se nuk përmbush në mënyrë të kënaqshme kërkesat e parimit të proporcionalitetit të dënimit me rrezikshmërinë e veprës, veçanërisht kur nuk është e pranishme ndonjë rrethanë që mund të rëndojë më tepër pozitën e autorit të veprës. P.sh. vepra penale të tilla si shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë, vjedhja e pasurisë së lënë në administrim, falsifikimi i dokumenteve, apo shpërdorimi i detyrës, mund të dënoheshin në mënyrë alternative me gjobë, në rastet kur vepra nuk ka shkaktuar pasoja të rënda ose kur profili i autorit të veprës flet për një person me rrezikshmëri të ulët shoqërore. Ndërkohë që, në bazë të ndryshimeve të bëra me ligj, gjykata nuk mund të vendosë dënim me gjobë për këto vepra. Ashpërsimi i dënimeve me qëllim parandalimin e veprave penale, nuk duket të ketë rezultate të dukshme në praktikë, nëse nuk kombinohet edhe me masa të tjera sociale. P.sh., në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme për krimin në vitin 2014 thuhet se vepra penale e vrasjes për shkak të marrëdhënieve familjare paraqet tendencë në rritje, me gjithë politikën e ashpër që

³⁷ Neni 48 i Ligjit nr. 144/2013 ‘Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë’

është ndjekur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda ndaj të pandehurve të akuzuar për këtë krim³⁸. Kujtojmë se me ndryshimet e vitit 2013, u vendosën marzhe dënimi tepër të larta (jo më pak se 25 vjet ose me burgim të përjetshëm) për autorët e vrasjeve brenda familjes.

Në Rekomandimet e Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorin e Përgjithshëm në 'Luftën kundër kriminalitetit për vitin 2015', kërkohet që politika penale e këtij organi të synojë drejt ashpërsimit të dënimit për veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake; veprat penale kundër mjedisit; veprën penale të ndërtimit të paligjshëm; veprën penale të vjedhjes së energjisë elektrike, etj.³⁹

Vlen të theksojmë këtu se rritja e masës së dënimit me burg shton numrin e të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit. Studimet tregojnë se afatet e gjata të vuajtjes së dënimit në burg, të kombinuara me norma të qëndrueshme të hyrjeve të reja në burgje, do të rezultonin sërish në një numër më të lartë të burgosurish⁴⁰.

Me ndryshimet që solli ligji 144/2013 në Kodin Penal, dënimi për prodhimin dhe mbajtjen pa leje të armëve u rrit ndjeshëm, e megjithatë në vitin 2014 numri i të dënuarve për këtë vepër mbeti në të njëjtin nivel krahasuar me vitin paraardhës (338 të dënuar përkundrajt 335 të dënuarve në 2013-ën). Nëse këto rekomandime i ballafaqojmë me qëndrimin e shprehur të komisionit të posaçëm parlamentar dhe grupit të ekspertëve të lartë për reformën në drejtësi, vihet re një mungesë koherence në lidhje me drejtimin që duhet të ndjekë politika penale për këtë kategori veprash penale. Sipas tyre, me ndryshimet e vazhdueshme ka ardhur si pasojë mos harmonizimi i dënimeve brenda dispozitave të Kodit Penal (p.sh. një armëmbajtje pa leje praktikisht mund të dënohet me të njëjtën masë sikurse dhe një vrasje)⁴¹. Komisioni ka shprehur gjithashtu mendimin se dënimet më të rënda, me marzhe dënimi në minimum më të rënda, për mos aplikimin e dënimeve alternative nga gjykata, nuk janë gjithmonë një zgjidhje efektive, dhe se caktimi i marzheve duhet të ndjekë një metodologji shkencore dhe jo një prirje të momentit për penalizimin e një sjellje të caktuar.⁴² Disa studiues kanë shprehur mendimin se afatet e gjata të dënimit me burg, ndonjëherë e humbasin qëllimin e tyre primar për rehabilitimin e të dënuarve, dhe mund të ndikojnë negativisht tek ata. Sipas tyre, në përgjithësi, normat e recidivizmit rriten me rritjen e kohës së qëndrimit në burg⁴³.

38 Sokolaj, T. *Raporti për krimin në vitin 2014, rriten vrasjet në familje*. <http://www.panorama.com.al/raporti-per-krimin-ne-vitin-2014-rriten-vrasjet-ne-familje/>

39 Rekomandime për Prokurorin e Përgjithshëm 'Në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2015', f. 9. Ministria e Drejtësisë <http://www.drejtësia.gov.al>

40 *Prison Overcrowding and Prison Population Inflation: Recommendation No. R (99) 22*, Adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 30 September 1999 and Report. (Council of Europe Pub., 2000), 41.

41 Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, "Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", qershor 2015, 158, <http://shqiptarja.com/>, aksesuar më 3 korrik 2015.

42 Shih më sipër "Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", 173.

43 Smith, P., Goggin, C., dhe Gendreau, P. *The Effects of Prison Sentences and Intermediate Sanctions on Recidivism: General Effects and Individual Differences* (2002), <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/ffcts-prsn-sntncs/ffcts-prsn-sntncs-eng.pdf> [15.06. 2013].

Për më tepër, ndër vite legjislacioni penal është bërë gjithnjë e më i detajuar, duke përfshirë rishtazi vepra ose grupe veprash penale, të cilat jo gjithmonë i shërbejnë apo janë në të njëjtën linjë me objektivat thelbësore që ndjek e drejta penale si një disiplinë e fushës publike. Gjithashtu, shkelje të tjera kundër moralit apo normave të mirësjelljes dhe bashkëjetesës, sikurse prishja e qetësisë publike, sjelljet e pamoralshme në publik⁴⁴, si dhe fyerja apo shpifja mes personave privatë, mundet të adresoheshin respektivisht nëpërmjet proceseve administrative ose civile, në vend që të ishin subjekt i ndëshkimit penal⁴⁵.

Kërkesat e politikës kundrejt prokurorisë dhe gjyqësorit për një qëndrim më të rreptë ndaj autorëve të veprave penale të lehta janë reflektuar edhe në fazën e caktimit të dënimit. Kështu, në vitin 2014, të dhënat statistikore tregojnë se janë dënuar 526 persona për lidhje të paligjshme ose vjedhje të energjisë elektrike, dhe 3372 persona për drejtim automjeti në gjendje të dehur ose pa dëshmi. Shifër kjo disa herë më e lartë krahasuar me numrin e të dënuarve për këto vepra në vitin 2013 (53 persona të dënuar për lidhje të paligjshme ose vjedhje të energjisë elektrike dhe 465 persona të dënuar për drejtim të automjetit në gjendje të dehur ose pa dëshmi⁴⁶).

Zgjidhja e problemit nuk duhet parë vetëm në ashpërsimin e dënimeve por edhe në gjetjen e mekanizmave që rrisin efektivitetin e zbatimit të ligjit. Duke qenë se ndryshimet në ligj janë të vonshme në kohë, nuk mund të thuhet se ato kanë ndikuar në mënyrë domethënëse në rritjen aktuale të fluksit të të dënuarve në IEVP. Megjithatë, ky qëndrim do të çonte në krijimin e një kategorie të qëndrueshme të burgosurish, dhe do të refleктоhej në mënyrë të pashmangshme në rritjen e mëtejshme të numrit të tyre.

4. Zbatimi i ulët i disa prej alternativave të dënimit me burgim

Alternativat e dënimit me burgim luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në diferencimin e të dënuarve, bazuar në karakteristikat dhe nevojat e tyre personale. Në vitin 2008, në Kodin Penal u sanksionuan një numër dënimesh alternative si gjysmëliria, pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, qëndrimi në shtëpi, puna në interes publik, ose lirimi me kusht. Autoriteti përgjegjës për zbatimin efektiv të dënimeve alternative dhe monitorimin e vazhdueshëm të të dënuarve të vendosur në një nga këto masa është Shërbimi i Provës. Është për t'u përgëzuar trendi në rritje i dhënies së dënimeve alternative nga gjykatat nga viti në vit.

44 Neni 274 i Kodit Penal të R.SH - Prishja e qetësisë publike 'Hedhja e gurëve apo sendeve të tjera në banesën e shtetasit, krijimi i zhurmave shqetësuese si, me anë të shkrepjes së armëve apo plasjeve të ndryshme, të përdorimit jashtë rregullave të sirenave të automjeteve, apo çdo lloj tjetër sjelljeje të papëlqyeshme, në rrugë, sheshe e vende publike, që cenojnë dukshëm qetësinë e moralin apo tregon mospërfillje të hapët për mjedisin, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet'.

45 Për një mendim të ngjashëm shih: 'OSCE media freedom representative, on official visit to Denmark, urges for full decriminalization of defamation, blasphemy.' <http://www.osce.org/fom/108769>, [1 korrik 2015].

46 Vjetari Statistikor 2014, Ministria e Drejtësisë, fq. 38-44, <http://www.drejtesia.gov.al/>.

Tabela 4.1

Lloji i dënimeve alternative	2011	2012	2013	2014
Neni 59 i KP, Pezullimi	1,616	2,166	1,758	3,189
Neni 59/a i KP, Qëndrimi në shtëpi	68	34	36	56
Neni 64 i KP, Lirimi me kusht	206	188	146	64
Neni 63 i KP, Punë në interes publik	226	214	145	694
Neni 58 i KP, Gjysmëliria	1	0	0	0
Totali	2,117	2,602	2,085	4,003

Megjithatë, duhet vënë në dukje se jo të gjitha alternativat e dënimit me burgim kanë gjetur zbatim të shpeshtë në praktikë. P.sh., dënimi alternativ i 'gjysmë-lirisë' ka gjetur zbatim vetëm një herë deri më sot.

Në bazë të ligjit, për dënime me burgim deri në një vit, gjykata mund të vendosë ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri duke marrë parasysh sipas rastit detyrimet e personit të dënuar në lidhje me punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor⁴⁷. I dënuari me regjimin e gjysmëlirisë është i detyruar të kthehet në burg pas plotësimit të detyrimeve apo nevojave përkatëse, brenda periudhës kohore të caktuar nga gjykata. Zbatimi i kësaj alternative të dënimit me burgim, kërkon vënien në funksionim të institucioneve të veçanta të dënimit, të ndryshme nga burgjet tradicionale, të cilat janë projektuar për vendosjen e të burgosurve të privuar nga liria gjatë gjithë kohës, e si rrjedhim, karakterizohen nga masa tepër kufizuese sigurie. Për zbatimin efektiv të këtij dënimi është e nevojshme të projektohen institucione të hapura të vuajtjes së dënimit, si dhe të angazhohen burime të mjaftueshme njerëzore për të monitoruar përmbushjen e detyrimeve edukative, profesionale, familjare ose mjekësore nga ana e të dënuarit.

Zbatim të ulët në praktikë ka pasur edhe dënimi alternativ i qëndrimit në shtëpi, e ndikuar kjo nga mungesa e numrit të nevojshëm të punonjësve për të bërë të mundur mbikëqyrjen e të dënuarit si dhe nga zbatimi i ulët i masës së mbikëqyrjes elektronike.

Në bazë të ligjit, mbikëqyrja elektronike përdoret ndër të tjera për personat të cilët janë subjekt i:

- *Masave shtrënguese të parashikuara nga shkronjat "a", "c" dhe "d" të nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale;*
- *Dënimeve alternative të parashikuara nga nenet 58, 59, 59/a dhe 64 të Kodit Penal⁴⁸;*

Numri i ulët i zbatimit në praktikë të rasteve të mbikëqyrjes elektronike ndikon

⁴⁷ Neni 58 i Kodit Penal

⁴⁸ Shih: Ligjin nr.10 494, dt 22.12.2011 "Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor".

drejtpërsëdrejti në reduktimin e mundësive për zbatimin e dënimeve alternative të tilla si qëndrimi në shtëpi apo lirimi me kusht.

Sipas të dhënave nga Shërbimi i Provës⁴⁹, sistemi i mbikëqyrjes elektronike ka një kapacitet total për mbikëqyrjen e 300 personave. Prej vitit 2013 kjo masë është aplikuar për 23 raste. Të gjithë subjektet e vendosura në mbikëqyrje kanë qenë të vendosur në masa shtrënguese, sipas nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale. Gjatë vitit 2015 në mbikëqyrje janë 15 raste.

Sipas praktikuesve të ligjit, arsyeja e zbatimit të ulët të kësaj mase lidhet me numrin e ulët të kërkesave për zbatimin e saj nga ana e prokurorëve, si dhe me qëndrimin shpeshherë të tërhequr të gjykatave ndaj kërkesave për zbatimin e saj.

Deri vonë, një faktor që pengonte zbatimin e gjerë të masës së mbikëqyrjes elektronike, ishte edhe shtrirja e kufizuar gjeografike e infrastrukturës mbështetëse teknike. Si rrjedhim, kjo masë mund të zbatohet efektivisht vetëm në rrethin e Tiranës.

Gjatë vitit 2015, infrastruktura e nevojshme mbështetëse është shtrirë në të gjitha rrethet e vendit, megjithatë, zbatimi mbetet përsëri i ulët për shkak të njohurive dhe ndërgjegjësimit të ulët nga aktorët e drejtësisë penale mbi rrethanat e zbatimit të kësaj mase.

5. *Trajtimi i personave me probleme të shëndetit mendor*

Detyrimet ligjore për ngritjen e institucioneve mjekësore të posaçme, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” nuk kanë gjetur zbatim⁵⁰. Trajtimi i kësaj kategorie të dënuarish në IEVP, vijon të mbetet i paligjshëm, duke ndikuar në një rritje artificiale të popullsisë së burgjeve.

Gjatë vitit 2015 janë evidentuar 98 persona në masën mjekim i detyruar dhe rreth 290 persona me probleme të shëndetit mendor. Këta persona mbahen në ambientet e Spitalit të Burgut dhe në IEVP Krujë me një kapacitet total prej 294 vendesh.

49 Të dhëna statistikore nga Shërbimi i Provës, shtator 2015.

50 Në nenin 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” parashikohet se:

- 1 Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, të cilët kanë kryer një vepër penale, dhe për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor për të paraburgosur apo të dënuar që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale.
2. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Rritja e kriminalitetit

6.1 Faktorët socio-ekonomikë

Problemi i tendencës në rritje të popullsisë së burgjeve nuk është vetëm rezultat i ndjekjes së politikave penale të papërshtatshme. Nuk duhet nënvlerësuar fakti që normat e larta të të paraburgosurve, tregojnë njëkohësisht për një rritje të kriminalitetit, çka do të reflektohej më tej në rritjen e popullsisë së burgjeve.

Zgjidhja e situatës së mbipopullimit në burgje kërkon zhvillimin e një politike penale gjithëpërfshirëse e cila të fokusohet jo vetëm në përpunimin e mekanizmave të duhur për ndëshkimin dhe trajtimin e të dënuarve, por edhe në hartimin e strategjive për parandalimin e krimit.

Ky proces kërkon një përjasje gjithëpërfshirëse si ndaj studimit të gjendjes aktuale të kriminalitetit në vend, ashtu edhe në drejtim të faktorëve të riskut dhe përpjesëtimit të tyre në rajone të ndryshme të vendit. Vëzhgimet e bëra në lidhje me të dënuarit aktualë tregojnë se faktorët kryesorë që ndikojnë në sjelljen kriminale kanë të bëjnë me strukturën sociale, kushtet e vështira ekonomike dhe eksperiencat të dhunës në familje. Sipas statistikave vjetore të Ministrisë së Drejtësisë veprat penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike vazhdojnë të jenë veprat penale me përhapje më të lartë.

Tabela në vijim tregon se veprat në fjalë zënë peshën kryesore të veprave penale në shkallë vendi në vitet e fundit.

Tabela 4.2

Persona të dënuar sipas kategorive të veprave penale (%)	2010	2011	2012	2013	2014
Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike	54	54	55	52	51
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike	30	31	31	30	30
Vepra penale kundër moralit, dinjitetit dhe familjes	2	2	2	6	9
Vepra penale kundër drejtësisë	4	5	4	3	3.5
Vepra penale kundër jetës	4	4	3	1	3
Vepra penale kundër shëndetit	2	2	2	2	2
Të tjera	4	3	3	6	2

Zhvillimi i qëndrueshëm dhe me tendencë në rritje i veprave penale kundër pasurisë, tregon se një nga faktorët dominues të shtytjes në krim është faktori ekonomik.

Sikurse mund të shihet në Tabelën 4.2, të dënuarit për këtë kategori veprash penale përfaqësojnë gjysmën e numrit total të të gjithë të dënuarve. Shkaqet kryesore të krimit ekonomik duhen parë të lidhura ngushtë me standardin e ulët të jetesës, mungesën e zhvillimit proporcional (të njëtrajtshëm) ekonomik midis zonave të ndryshme gjeografike, dhe normat e larta të papunësisë tek të rinjtë. Në Shqipëri vërehet një disproporcionalitet i theksuar në zhvillimin ekonomik të qyteteve

dhe fshatrave si dhe të qyteteve midis tyre. Kjo ka ardhur kryesisht si pasojë e dështimit të politikave qeveritare në promovimin dhe mbështetjen e një ekonomie të mirëstrukturuar dhe me shtrirje të gjerë nga pikëpamja gjeografike. Investimet dhe objektet industriale kryesore janë përqendruar në disa prej qyteteve të mëdha, çka ka theksuar disbalancat në zhvillimin e qendrave urbane dhe zonave të largëta rurale. Mungesa e investimeve dhe burimet e kufizuara lokale për mbështetjen e zhvillimit ekonomik kanë shtuar papunësinë, dhe si rrjedhim kanë çuar në një situatë ekonomike edhe më të rënduar në këto zona. Disproporcionaliteti në zhvillimin ekonomik ka gjeneruar vazhdimisht valë lëvizjesh të pakontrolluara demografike në drejtim të qyteteve të mëdha, duke ndikuar në rritjen e hendekut midis ofertës dhe kërkesës në tregun e punës.

Pabarazia e të ardhurave është një tjetër problem i zhvilluar ndjeshëm prej ndryshimeve të shpejta në strukturën sociale të qyteteve. Studimet tregojnë se papunësia dhe/ose pabarazia në të ardhura, së bashku me faktorë risku të personalitetit, mund të shkaktojnë përfshirjen në sjellje kriminale⁵¹.

Të dhënat statistikore tregojnë se normat e papunësisë mbeten të larta, veçanërisht për grupmoshën 15-29 vjeç ku norma e papunësisë është 34,1. Në krahasim me vitet e mëparshme, norma e papunësisë tek të rinjtë ka ardhur duke u rritur⁵².

Norma e papunësisë						
Grupmosha	2010	2011	2012	2013	2014	2015
15-29	22,5	21,9	26,0	27,2	32,5	34,1
15-64	14,2	14,3	13,8	16,4	17,9	17,3

Kërkimet tregojnë se normat e larta të papunësisë mund të intensifikojnë shtytjet drejt krimit. Sipas modelit (teorisë) të parandalimit Becker-Ehrlich “qenia në moshë të re dhe i papunë rrit shanset për të kryer një krim ”⁵³.

Nga studimi i përbërjes aktuale të popullsisë së burgjeve, vëmë re se një pjesë e konsiderueshme e të burgosurve i përkasin grupmoshës së re 18<30 vjeç. Kjo kategori të dënuarish, përbën 47.4% të totalit të personave të dënuar.

Në përfundim, vlen të theksojmë se në hartimin e politikave për parandalimin e krimit, i duhet dhënë rëndësia e duhur studimit të elementëve social-ekonomikë që ndikojnë në kriminalitet, me qëllim parandalimin e hershëm të sjelljes kriminale.

51 Shih: Philip Feldman, *The Psychology of Crime: A Social Science Textbook*, (Cambridge: Cambridge University Press, 1993), 253-258.

52 Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2007-2014, <http://www.instat.gov.a>

53 Sunčica Vujić, *Econometric studies to the economic and social factors of crime*, (Tinbergen Institute research series, no.454, 2009), 98.



PJESA III

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në vija të përgjithshme, për hartimin e një politike efektive për uljen e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale është e nevojshme të rivlerësohet politika penale aktuale si dhe praktika e veprimit të organeve të drejtësisë penale. Në Shqipëri, tradicionalisht përgjigja shtetërore ndaj problemeve të krimit është bazuar përgjithësisht në përgjigjen e institucionalizuar të sistemit të drejtësisë penale. Deri më tani, duket se dominimi i përqasjes ndëshkuese nuk është shoqëruar me rezultate të kënaqshme në uljen e normave të krimit. Të dhënat statistikore të viteve të fundit tregojnë se numri i çështjeve penale ka ardhur duke u rritur.

Të dhënat për rritjen e kriminalitetit përballin qeveritë me dilemën e vështirë për kalimin drejt një politike më të ashpër ndëshkuese apo investimi më të madh në politika sociale dhe përpunimi të instrumenteve komunitarë të kontrollit të sjelljes deviante.

Ky dokument synon t'u vijë në ndihmë politikëbërësve duke propozuar një sërë rekomandimesh mbi linjat e mundshme të veprimit në fushën e politikës penale dhe administrimit të sistemit penitenciar.

Në pjesën në vijim parashtrohen disa rekomandime mbi ndërhyrje të mëtejshme, të cilat paraqiten të nevojshme për adresimin e problemeve me të cilat përballet sot sistemi penitenciar.

1. *Në lidhje me orientimet e përgjithshme të politikës penale*

Konkluzione

- Praktika e deritanishme tregon një rritje të ndjeshme të caktimit të dënimit me burgim në raport me format e tjera të dënimeve kryesore apo alternative. Më shumë vëmendje i është kushtuar efektit parandalues që ka në shoqëri aplikimi i masës së dënimit me burg ndaj autorëve të veprave penale të caktuara, se sa në efektin parandalues që do të kishte dënimi tek vetë këta persona.

- Prirja për t'i kthyer dënimet penale në instrumente për menaxhimin e rrezikut dhe përmbushjen e objektivave të rendit dhe sigurisë publike e largon vëmendjen e sistemit të drejtësisë penale nga faji i individit (për veprën e kryer në të shkuarën) duke u fokusuar në mënyrë primare në rrezikun e sjelljes së ardhshme kriminale⁵⁴. Në këtë rast, dënimi penal i përgjigjet asaj çka mund të ndodhë në të ardhmen dhe kthehet nga një mekanizëm i kontrollit social, në një mekanizëm 'të mbrojtjes sociale'. Kështu, ligji penal rrezikon të kthehet në një element të politikave të përgjithshme të sigurisë, të cilat synojnë të optimizojnë mbrojtjen nga individë të rrezikshëm nën koston e drejtësisë dhe të proporcionalitetit të dënimit⁵⁵.
- Tashmë përbën një përgjithësim të mbështetur në praktikë se kur qeveritë pozicionohen në një përjasje ndëshkuese ndaj krimit, duke dështuar në adresimin e faktorëve kryesorë që çojnë në sjellje kriminale, strukturës së popullsisë së burgjeve i shtohen më shumë të dënuar nga grupet sociale më vulnerabël dhe më pak të dënuar nga radhët e kriminelëve të rrezikshëm dhe të dhunshëm⁵⁶. Për më tepër, kritikët e politikave të parandalimit situacional të krimit theksojnë se nëse nuk merren masa për të dekurajuar motivimin kriminal, reduktimi i mundësive për të kryer krim do të çonte thjesht në një rishpërndarje, por jo ulje të kriminalitetit⁵⁷.
- Një tendencë e tillë paraqitet problematike, pasi rrezikon të mos përmbushë me sukses si funksionin e parandalimit të përgjithshëm të krimit, ashtu edhe atë të parandalimit individual. Studimet tregojnë se nuk ka një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të qëndrueshme midis rritjes së dënimeve me burg dhe uljes së normave të krimit⁵⁸. Edhe në rastet kur pranohet të ketë një korrelacion midis të dyjave, efekti i normave të larta të dënimit në uljen e normave të krimit duket të jetë i ulët, madje në disa raste edhe kontradiktor⁵⁹. Kjo përforcon edhe më tepër qëndrimin se krahas politikave të ashpra penale, janë një sërë faktorësh të lidhur me kushtet sociale, ekonomike, karakteristikat e strukturimit të komuniteteve lokale, të cilët ndikojnë në uljen apo rritjen e kriminalitetit në periudha të caktuara.
- Duke pasur si objektiv parësor impaktin që dënimi i shkelësit do të ketë në komunitet, largohet vëmendja nga roli specifik që do të kishte privimi nga

54 Shih: Albrecht, H.J. Criminal Sanctions and Crime Control: Past, Presence and Future in Europe. Libri i punimeve të simpoziumit shkencor 'Criminal Justice System and the Social Welfare', 2015, f. 10 Tiranë: Shtypshkronja 'Mileniumi i Ri

55 Hassemer, W. (2006). Sicherheit durch Strafrecht. HRR-Strafrecht 7(4), 130-143, cituar nga Albrecht, H.J. Criminal Sanctions and Crime Control: Past, Presence and Future in Europe.... 2015, f. 10.

56 Shih: United Nations Office on Drugs And Crime (2013). *Custodial and Non-Custodial Measures: The Prison System*, f. 1, http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/cjat_eng/1_Prison_%20System.pdf, aksesuar 30 qershor 2015.

57 Clarke, R.V. Situational Prevention, Criminology and Social Values., in Von Hirsch, A., Garland, D., & Wakefield, A. (2000). *Ethical and Social Perspectives on Situational Crime Prevention*. Portland: Hart Publishing.

58 Aebi, M.F., Linde, A., dhe Delgrande, N. Is There a Relationship Between Imprisonment and Crime in Western Europe?. *European Journal of Criminal Policy and Research*, 2015, fq. 1-22.

59 Kështu, studimet mbi efektin afatgjatë që ka rritja e normave të dënimit me burg në reduktimin e kriminalitetit në SHBA, kanë treguar se nuk ka një lidhje të fortë midis tyre dhe se kjo lidhje në disa raste duket të jetë kontradiktore. Shih: Brym, R. J., dhe Lie, J. *Sociology: Pop Culture to Social Structure*, Belmont: Wadsworth Cengage Learning, 2013, f. 117; si dhe Shahidullah, S.H.M. *Crime Policy in America: Law, Institutions and Programs*. Lanham, University Press of America, 2008, f.272.

liria tek individit konkret, sidomos tek shkelësit për herë të parë. Dënimi me burgim i shkelësve për herë të parë mund të bëhet shkak për ripërfshirjen në sjellje deviante në të ardhmen. Midis ekspertëve shprehet gjithnjë shqetësimi se burgjet mund të ndikojnë në formimin e modeleve të sjelljeve akoma edhe më të dhunshme tek të dënuarit. Jetesa në burg karakterizohet nga një sërë faktorësh presionues siç është jetesa e vetmuar apo ekspozimi ndaj dhunës fizike. Ndërkohë që të ardhurat për të siguruar arsimim, trajnim profesional, programe të argëtimit, aktivitetit fizik apo këshillimit psikologjik janë të ulëta. Kjo çon rrjedhimisht në një popullsi të burgjeve që është gjithnjë e më shumë subjekt i presioneve psikologjike, pa përgatitje profesionale dhe me mungesë mundësish për punësim, e cila paraqet më shumë rrezik pas daljes nga sistemi penitenciar se sa në momentin e hyrjes në burg⁶⁰.

- Gjithashtu, nuk duhet neglizhuar efekti negativ që dënimi me burgim i një personi të rritur mund të ketë në familjen e tij. Kriminologët mendojnë se përçarja e familjes mund të jetë një faktor që mund të influencojë ndjeshëm në përfshirjen në sjellje deviante të fëmijëve të mbetur jashtë vëmendjes/kontrollit të njërit prej prindërve⁶¹.
- Për sa më sipër, shihet se intensifikimi i normave të ndëshkimit ka gjasa që të ndikojë në përshkallëzimin e krimit. Kështu, në vend që të veprojë si frenues i krimit, dënimi me burgim mund të shkaktojë në terma afatgjatë rritje të normave të krimit⁶².

Rekomandime:

- Rëndësi thelbësore paraqet rishikimi i politikës ndëshkuese nën optikën e racionalizimit të saj. Në instrumentet ndërkombëtare rekomandohet dekriminalizimi i disa llojeve të veprave penale ose riklasifikimi i tyre në vepra penale më të lehta në mënyrë që të mos çojnë në dhënien e dënimeve me heqje të lirisë⁶³.
- Është e rëndësishme që përgjigja e sistemit të drejtësisë penale të fokusohet më shumë në interesat e parandalimit të veçantë të krimit krahas objektivave të parandalimit të përgjithshëm.
- Vëmendje gjithnjë e më e lartë duhet t'u kushtohet veçanërisht politikave me bazë komunitare për parandalimin e krimit apo adresimin e sjelljes kriminale. Këto politika nisen nga premisa se strategjitë për parandalimin e krimit dhe trajtimin

60 Shih: Moore, L. D., dhe Elkavich, A. (2008). Who's using and who's doing time: Incarceration, the war on drugs, and public health. *American Journal of Public Health*, 98(5), 782–786, cituar në: Brym, R. J., dhe Lie, J. *Sociology: Pop Culture to Social Structure*, Belmont: Wadsworth Cengage Learning, 2013, f. 117.

61 Shih: Gaines, L.K., dhe Mille, R.L. *Criminal Justice in Action: The Core*. 8th edition. Boston: Cengage Learning. 2013, fq. 134-168.

62 Shih: Lynch, J., dhe Sabol, W. (2010). Prisoner Reentry in Perspective', cituar në Siegel, L. *Criminology*. 2012, f. 128, Belmont: Wadsworth, Cengage Learning.

63 Shih më sipër: Recommendation No. R(99) 22, (para 4).

e problemeve të sjelljes deviante mund të funksionojnë në mënyrë më efektive nëse përshtaten me nevojat dhe problemet specifike të komuniteteve lokale. Politikat mbështetëse sociale e vendosin theksin në rehabilitimin e shkelësit, si dhe në rehabilitimin e shoqërisë apo të komunitetit në tërësi, në mënyrë që të shmangin nevojën e një individi për t'u përfshirë në sjellje kriminale⁶⁴.

- Duhet të shikohet mundësia e uljes së dënimit minimal me burgim për një numër veprash penale, për të bërë të mundur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe zbatimin e një prej alternativave të dënimit me burgim. Gjykata mund të vendosë të zëvendësojë dënimin me burg me një nga dënimet alternative të gjysmëlirisë, qëndrimit në shtëpi apo punës në interes publik, në rastet kur masa e dënimit të dhënë prej saj është, sipas rastit, deri në një vit apo deri në dy vjet. Në qoftë se dënimi minimal që parashikon ligji për veprën penale të kryer është më i lartë se dy vjet, atëherë gjykata nuk do të mund të lejojë zbatimin e një prej këtyre dënimeve alternative në vend të dënimit me burg. Edhe pse sipas nenit 58 të Kodit Penal, gjykatës i njihet mundësia që të ulë dënimin nën kufijtë e parashikuar nga ligji, rikujtojmë që kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm në raste të veçanta. Për këtë arsye, ndërhyrja ligjore për uljen e përgjithshme të dënimit minimal me burg për veprat që paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore, mbetet e nevojshme.
- Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe racionalizimit të termave të dënimit maksimal. Në këtë drejtim, nevojitet një vlerësim gjithëpërfshirës i strukturës së veprave penale në dispozitat e Kodit Penal me qëllim studimin e proporcionalitetit midis masës së dënimit dhe rëndësisë së veprës. Duhet të merret në konsideratë impakti negativ që afatet e gjata të dënimit me burg mund të kenë në zhvillimin e popullsisë së burgjeve në të ardhmen,⁶⁵ si dhe në rritjen e shanseve për ripërfshirje në sjellje kriminale.
- Riklasifikimi i veprave penale dhe ulja e termave të dënimit minimal dhe maksimal për disa vepra penale, do të kontribuonte në uljen e kohëzgjatjes së periudhës së paraburgimit (duke qenë se afatet e paraburgimit llogariten në mënyrë proporcionale me afatet e dënimit të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri), dhe si rrjedhim do të përmirësonte situatën e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Zgjidhja e situatës së mbipopullimit në burgje kërkon zhvillimin e një politike penale, e cila të angazhohet në mënyrë primare në hartimin e strategjive për parandalimin e krimit. Ky proces kërkon pikësëpari një studim gjithëpërfshirës të

64 Roberts, A.R., & Springer, D.W. (2007). *Social Work in Juvenile and Criminal Justice Settings, 3rd edition*. Springfield: Charles C Thomas Publisher.

65 Studimet e fundit mbi trendin e popullsisë së burgjeve në Evropë, tregojnë se dënimet e gjata, janë një nga faktorët kryesorë që kanë ndikuar në mbipopullimin e burgjeve në shtete të ndryshme. Kështu, edhe pse numri i hyrjeve të reja në burgje ka ardhur duke u ulur ose ka mbetur konstant, numri total i popullsisë së burgjeve ka ardhur gjithnjë duke u rritur për shkak të shtimit të numrit të dënimeve të gjata me burg. Shih: Aebi, M.F., Linde, A., dhe Delgrande, N. Is There a Relationship Between Imprisonment and Crime in Western Europe?. *European Journal of Criminal Policy and Research*, 2015, fq. 1-22.

gjendjes aktuale të kriminalitetit në vend, të faktorëve të riskut dhe përpjesëtimin të tyre në rajone të ndryshme të vendit. Për të dekurajuar motivimin kriminal është e nevojshme të ndërmerren reforma të thella strukturore, të cilat të garantojnë një shtrijsë të gjerë dhe proporcionale të masave ekonomike dhe sociale në rajone të ndryshme të vendit.

- Në përcaktimin e objektivave kryesorë të politikës penale dhe masave për arritjen e tyre, do të ishte me vlerë ngritja e një Komiteti të përbërë nga profesionistë dhe studiues të fushës, i cili të funksiononte mbi bazën e takimeve periodike për të diskutuar mbi çështjet në fjalë. Kjo do të bënte të mundur krijimin e një mendimi kompetent mbi problemet e politikës penale, dhe në të njëjtën kohë të distancuar nga objektivat e mirëfilltë politike të njëjës apo tjetrës forcë politike.

2. Në lidhje me politikën penale ndaj të miturve

- Praktikant e ndëshkimit luajnë një rol tepër të madh në modifikimin e sjelljes së shkelësve të mitur, dhe në veçanti të atyre që kanë kryer një shkelje për herë të parë. Nëse masat ndaj të miturve që shkelin ligjin nuk caktohen dhe/ose zbatohen në mënyrë të përshtatshme, kjo mund të rrisë prirjet e tyre të ardhshme për krim. Lloji kryesor i dënimit i vendosur nga gjykata ndaj shkelësve të mitur mbetet dënimi me burgim. Vlen të theksojmë se caktimi i kësaj mase dënimi për të miturit, nuk mund të përmbushë në mënyrë të kënaqshme kërkesat për rehabilitimin e tyre dhe veçanërisht nevojat e tyre për edukim, mbështetje familjare, trajtim profesional, punësim, dhe përfshirje sociale.
- Për të miturit autorë të veprave penale vihet re një trend i qëndrueshëm në zbatimin e dënimit me burgim deri në dy vjet. Efiçenca e dënimit me burg deri në dy vjet paraqitet problematike për sa i takon përmbushjes së objektivave për rehabilitimin e të dënuarve jo të rrezikshëm. Orientimi drejt dënimeve të shkurtra me burg për të miturit, krahas rëndimit të gjendjes së mbipopullimit, mund të influencojë negativisht në përpjekjet për rimodelimin e sjelljes së tyre.
- Tendanca në rritje e recidivizmit tek të miturit, tregon akoma dhe më shumë se izolimi rezulton të jetë inefiçent në neutralizimin e rrezikut kriminal tek të miturit.
- Një problem të veçantë në sistemin e drejtësisë penale për të mitur paraqet mungesa e institucioneve të veçanta edukuese për të mitur. Në nenin 46 të Kodit Penal parashikohet se "...ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale, mund të jepen masa edukueseMasa edukuese që merret në raste të tilla është vendosja e të miturit në një institucion edukimi". Prokurori i Përgjithshëm është shprehur se masat e edukimit të detyruar ndaj të miturve të përjashtuar nga ndëshkimi, mbeten të pazbatueshme pasi nuk ekziston ende një institucion i veçantë

edukimi në strukturën e institucioneve të trajtimit të të miturve⁶⁶.

- Mungesa e institucioneve të edukimit të të miturve, në mënyrë të pashmangshme ndikon në rritjen e tendencës për dhënien e masave më të ashpra ndaj të miturve, edhe pse rrethanat lejojnë zbatimin e formave më të lehta të dënimit.

Rekomandime

- Politikat e ndëshkimit të të miturve duhet të orientohen nga një perspektivë e 'ndërhyrjes minimale' që mbështet aplikimin e masës së arrestit në burg apo të dënimit me heqje lirie vetëm nëse është absolutisht e nevojshme. Aktorët e drejtësisë për të mitur duhet të balancojnë nevojën për të përmbushur objektivat e sigurisë publike me kërkesat e planeve për riintegrimin e të miturve, dhe veçanërisht me nevojat e tyre për edukim, strehim, mbikëqyrje familjare, punësim, trajtim mjekësor dhe përfshirje sociale.
- Zbatimi i alternativave të dënimit me burgim, ofron një sërë mundësish për arritjen e këtyre qëllimeve nëpërmjet masave kontrolluese efektive dhe njësoj kërkuese ndaj sjelljes së tyre. Sanksionet me bazë komunitare krijojnë një mjedis edukimi dhe aftësimi më natyral, dhe si rrjedhim, kanë premisa për të përçuar më mirë mesazhet e sjelljes në mënyrë të përgjegjshme tek të miturit.
- Mënyra më e mirë për trajtimin e të miturve të përjashtuar nga dënimi, do të ishte sistemimi i tyre në *qendra pritëse (attendance centres)* si marrës të shërbimeve të veçanta në bazë të nevojave të tyre. Për këtë qëllim është e nevojshme që neni 46 i Kodit Penal të riformulohet, duke parashikuar që 'ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që për shkak të moshës nuk kanë përgjegjësi penale gjykata mund të vendosë ndjekjen e një programi të detyruar në qendra pritëse'. Këto qendra mund të ngrihen dhe administrohen në bashkëpunim të ngushtë midis DPB-së dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.
- Ndryshimi i masës së vendosjes në një institucion edukues me atë të ndjekjes së programeve specifike pranë qendrave të veçanta, do të bënte të mundur ofrimin e një asistence më gjithëpërfshirëse ndaj të miturve në konflikt me ligjin, e cila shkon përtej objektivave të edukimit të tyre. Në qendrat e kujdesit të veçantë për të mitur, krahas programeve edukuese, do të mundësohej edhe ofrimi i asistencës psiko-sociale për probleme të ndryshme si p.sh. për problemet në socializim, menaxhimin e zemërimit etj.

66 Raport vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm 2013. http://www.pp.gov.al/web/raporti_2013_855.pdf

3. Në lidhje me zbatimin e alternativave të dënimit me burgim**Konkluzione**

- Zbatimi i gjerë i dënimeve alternative do mundësonte sistemin e drejtësisë penale të zhvendoste fokusin nga përqasja tradicionale e fokusimit vetëm në sjelljen e shkelësit; në vend të saj sistemi do të angazhohej në mënyrë primare në krijimin e mundësive që e lejojnë shkelësin të tregojë aftësitë (sjelljen kompetente) të tij dhe të ndërtojë lidhje në komunitet.
- Edhe pse zbatimi i alternativave të dënimit me burg ka ardhur duke u rritur nga viti në vit, zbatimi i këtyre masave vazhdon të mbetet në nivele të ulëta krahasuar me numrin total të personave të dënuar çdo vit. Dënimi me burgim vazhdon të aplikohet në masë nga gjykata, duke ndikuar në rritjen e mëtejshme të fluksit të popullsisë së burgjeve.
- Ritmet jo të larta të zbatimit të këtyre dënimeve lidhen kryesisht me mungesën e infrastrukturës së nevojshme mbështetëse, skepticizmin nga ana e gjykatës në lidhje me efektivitetin e këtyre masave në rehabilitimin e të dënuarit, si dhe diskrecionin e lartë që ka gjykata në caktimin ose jo të këtyre dënimeve bazuar në rregullimin ligjor aktual.
- Zbatimi i ulët i dënimit alternativ të «qëndrimit në shtëpi» ka ardhur edhe si pasojë e zbatimit të ulët në praktikë të masës së mbikëqyrjes elektronike. Nga fillimi i aplikimit të kësaj mase në vitin 2013, numërohen vetëm 23 raste personash të vendosur në mbikëqyrje elektronike, ndërkohë që sistemi ka kapacitet për të mbuluar mbikëqyrjen e 300 personave⁶⁷. Edhe në rastet kur është aplikuar si masë, të gjithë subjektet e vendosur në mbikëqyrje kanë qenë të vendosur në masa shtrënguese, sipas nenit 232 të Kodit të Procedurës Penale, por jo subjekte të dënuar, për të cilët gjykata ka vendosur zëvendësimin e dënimit me burg me dënimin alternativ të qëndrimit në shtëpi.
- Sipas mendimit të Grupit të Lartë të Ekspertëve për Reformën në Drejtësi, problematika në lidhje me këtë lloj mbikëqyrje të veçantë qëndron në faktin se Kodi i Procedurës Penale nuk ka parashikuar ndonjë kriter të veçantë aplikimi⁶⁸. Gjithashtu, mosparashikimi i kriterëve se kur duhet të zbatohet mbikëqyrja elektronike nuk është në përputhje me Parimin 58 të Rekomandimit CM/Rec (2010) 1 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës (KiE) “Mbi Rregullat e Provës të Këshillit të Evropës” parashikon se “Niveli i mbikëqyrjes teknologjike nuk duhet të jetë më i madh se sa është e nevojshme në një rast individual, duke marrë në konsideratë seriozitetin e veprës së kryer dhe rrezikun që i kanoset sigurisë së komunitetit”.

67 Të dhëna të marra në mënyrë zyrtare nga Shërbimi i Provës.

68 Shih: Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, qershor, 2015, f. 163. Burimi: <http://shqiptarja.com/>.

- *Një element procedural që ndikon në praktikën e zbatimit të dënimeve alternative mbetet edhe mungesa e rregullimit të statusit ligjor të Shërbimit të Provës në Kodin e Procedurës Penale. Sikurse është evidentuar edhe nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Reformën në Drejtësi, ligji nuk ka përcaktuar kriteret e qarta në lidhje me rastet se kur është i nevojshëm hartimi i një raporti vlerësimi nga ana e Shërbimit të Provës, qoftë për prokurorinë qoftë për gjykatën dhe se në asnjë vend nuk është parashikuar se çfarë vlere kanë këto raporte në procesin penal⁶⁹.*

Rekomandime

- *Përpunimi i mekanizmave efektivë të kontrollit mbi disponimet e gjykatës për dënimet alternative*

Formulimi aktual i dispozitave mbi alternativat e dënimit me burgim lë hapësirë për shumë diskrecion gjyqësor për sa i takon vlerësimin të mundësisë së zbatimit të tyre. Kështu, shprehja e përgjithshme që përdoret në këto dispozita është se gjykata në praninë e disa rrethanave që lidhen me cilësitë apo kushtet personale të autorit të veprës penale apo me veprën e kryer prej tij *mund të vendosë* pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zbatimin nga i dënuari të një dënimi alternativ⁷⁰. Në këto kushte, mbetet në vlerësimin personal të gjyqtarit nëse do të marrë parasysh apo jo mundësinë e zbatimit të një dënimi alternativ në vend të dënimit me burg. Për më tepër, gjyqtari nuk është i detyruar të arsyetojë në vendimin final të caktimit të dënimit mbi faktin e refuzimit të kërkesës për vendosjen e një dënimi alternativ.

Kjo e bën të pamundur mundësinë e apelimit të vendimit të gjykatës, në rastet kur objekti i kërkesës në apel do të ishte vetëm rishqyrtimi i qëndrimit të gjykatës për refuzimin e vendosjes së një dënimi alternativ. Mungesa e mundësive efektive për apelim të rasteve të mospranimit nga gjykata të kërkesave për zbatimin e dënimeve alternative ka një ndikim jo të vogël në uljen e mundësive praktike të zbatimit të dënimeve alternative. Gjithashtu, mungesa e mekanizmave të llogaridhënies së gjyqësorit për rastet e refuzimit të vendosjes së dënimeve alternative, mund të ndikojë edhe në uljen e predispozicionit të gjykatave për zbatimin e këtyre dënimeve.

69 Për më tepër shih: “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, qershor, 2015, f. 174. Burimi: <http://shqiptarja.com>

70 P.sh. në nenin 58 të Kodit Penal – Gjysmëliria, thuhet se ‘Për dënimin me burgim deri në një vit, **gjykata**, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar për punën, arsimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësitë thelbësore familjare apo për nevojën për trajtim ose rehabilitim mjekësor, **mund të vendosë** ekzekutimin e vendimit me burgim me gjysmëliri.

Po ashtu, në nenin 59 - Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, thuhet se ‘Për shkak të rrezikshmërisë së paktë të personit, moshës, kushteve shëndetësore apo mendore, ... rrethanave të kryerjes së veprës penale, si dhe të sjelljes pas kryerjes së veprës penale, **gjykata**, kur jep dënim me burg deri në pesë, vjet, **mund të urdhërojë** që i dënuari të mbajë kontakte me shërbimin e provës dhe të vihet në provë, duke pezulluar ekzekutimin e dënimit, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale. I njëjti formulim vihet re edhe në dispozitat që sanksionojnë forma të tjera të dënimeve alternative, konkretisht nenet 59/a, 63,64 të Kodit Penal.

- Për të zvogëluar diskrecionin gjyqësor në caktimin e dënimeve alternative do të ishte i nevojshëm riformulimi i dispozitave në fjalë në trajtën: **“gjykata duhet të marrë (merr) në konsideratë mundësinë e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe caktimin e një dënimi alternativ”**. Në këto kushte, në të gjitha ato raste kur rrezikshmëria e ulët e autorit dhe e veprës e lejon, gjykata do të ishte e detyruar që të merrte në konsideratë mundësinë e vendosjes së një dënimi alternativ në vend të dënimit me burg, dhe në rast refuzimi, të shpjegonte arsyet për mospranimin e pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burg.
- Kjo do i jepte të dënuarit edhe mundësinë që të ushtronte të drejtën e ankimit ndaj vendimit të gjykatës në lidhje me disponimet mbi moszbatueshmërinë e dënimit alternativ.
- Shtimi i presionit për vlerësimin e zbatimit të dënimeve alternative, dhe garantimi i mekanizmave të kontrollit mbi veprimtarinë e gjykatës në zbatimin e këtyre dënimeve, do të kishte një efekt të drejtpërdrejtë edhe në uljen e pasivitetit të përgjithshëm që vihet re nga ana e gjyqësorit në lidhje me këto praktika. Pasivitet ky që, përveç skepticizmit mbi efektshmërinë e dënimeve alternative, shkaktohet pjesërisht edhe nga pozita më komode që siguron vendosja e një dënimi me burgim, në krahasim me procedurën e vendosjes së një dënimi alternativ, e cila kërkon një investim më të madh kohor dhe energjish nga ana e gjyqtarëve, por që ka një kosto shumë herë më të ulët për shtetin, nga ana tjetër.
- Më shumë përpjekje duhen bërë për ngritjen e strukturave të përshtatshme monitoruese të dënimit alternativ të gjysmëlirisë në mënyrë që të përhapet aplikimi i kësaj alternative dënimi për kategorinë e shkelësve që paraqesin rrezikshmëri të ulët shoqërore.
- Zbatimi i kësaj mase do të përbënte gjithashtu një zgjidhje efektive për rehabilitimin e autorëve të mitur, që janë jetimë apo që kanë një historik dhune në familje. Për këtë kategori, nuk mund të zbatohet alternativa e qëndrimit në shtëpi, dhe në rast të mungesës së mekanizmave efektive për vendosjen e tyre në regjimin e gjysmëlirisë, gjykata do të shihte dënimin e tyre me burg si alternativën e vetme të mbetur.
- Për të siguruar një infrastrukturë të qëndrueshme për punësimin e të dënuarve me punë në interes publik është e nevojshme të zgjerohet kuadri bashkëpunues midis Shërbimit të Provës dhe agjencive publike dhe organizatave private, dhe kur është e mundur ky bashkëpunim të bazohet në marrëveshje të shkruara, ku secila nga palët merr përsipër angazhime afatgjata në kohë si dhe përgjegjësi për përmbushjen me sukses të tyre.
- Zgjerimi i kapaciteteve institucionale në fushën e zbatimit të dënimeve alternative, do t’u jepte gjyqtarëve dhe prokurorëve më shumë besim në

efektivitetin e zbatimit të dënimeve alternative në komunitet, dhe si rrjedhim do të rriste disponueshmërinë për aplikimin e tyre për dënime të ulëta me burg⁷¹.

- Për zgjerimin e aplikimit të masës së mbikëqyrjes elektronike, sikurse është evidentuar edhe nga aktorët e sistemit të drejtësisë, paraqitet i nevojshëm parashikimi në Kodin e Procedurës Penale i kriterëve se kur duhet të zbatohet mbikëqyrja elektronike dhe rregullimi i kufijve të kësaj mase.
- Mbetet e nevojshme që në Kodin e Procedurës Penale të përfshihen parashikime të qarta mbi rolin e Shërbimit të Provës në të gjitha fazat e procedimit penal.
- Ndërgjegjësimi dhe rritja e besimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve mbi efektivitetin e dënimeve alternative, si dhe trajnimi i tyre mbi rrethanat e zbatimit të masës së mbikëqyrjes elektronike.
- Një zhvillim me rëndësi praktike do të ishte edhe hartimi i një manuali për gjyqtarët dhe prokurorët lidhur me zbatimin e mbikëqyrjes elektronike.

4. Në lidhje me vlerësimin e rrezikshmërisë së të dënuarve dhe caktimin e llojit të dënimit apo vendit të vuajtjes së dënimit

Rekomandime

- Për një menaxhim më racional dhe më eficient të burimeve të sistemit penitenciar është e nevojshme të ndërtohet një Sistem i Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikshmërisë për të dënuarit me burgim, përfshirë këtu edhe një Sistem për të Miturit dhe të Rinjtë në Moshë Madhore. Instrumentet e vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut konsiderohen tashmë një pjesë integrale e përgjigjes së sistemit të drejtësisë penale kundër krimi⁷². Konsolidimi i një sistemi të tillë do të rriste besimin e gjykatës mbi saktësinë e vlerësimeve të dhëna lidhur me shkallën e rrezikshmërisë së autorëve të veprave penale, dhe si rrjedhim, do të reduktonte prirjet për aplikimin e dënimit me burgim, vetëm në ato raste kur rrezikshmëria e autorit të veprës nuk do të justifikonte një masë tjetër më të lehtë. Kjo pasi, përpunimi i instrumenteve vlerësues ndihmon së tepërmi gjykatën në ndërtimin e një profili sa më qartë të shkelësve, në sajë të shqyrtimit paraprak të raporteve të mirëstrukturuara që përmbajnë të dhëna të plota për aspekte

71 Rekomandim nr. R(99) 2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës 'Concerning prison overcrowding and prison population inflation', (para. 22), <http://pjp-eu.coe.int/>, aksesuar 1 korrik 2015

72 Roesch, R., Zapf, P., dhe Hart, S.D. *Forensic Psychology and Law*. Hoboken: John Wiley & Sons, 2010, f. 274.

të personalitetit dhe mënyrës së jetesës së shkelësit⁷³.

- Raporti i vlerësimit të rrezikshmërisë së shkelësit duhet të marrë njëkohësisht në konsideratë dy elementë: rrezikun që paraqet i dënuari për t'u arratisur nga vendi i vuajtjes së dënimit si dhe rrezikshmërinë që i dënuari paraqet për shoqërinë nëse lihet i lirë.
- Një raport për vlerësimin e personalitetit ndahet në seksione të veçanta që përmbajnë zakonisht këto kategori të dhënash: a) mjedisi familjar, lidhjet sociale, kushtet e jetesës; b) arsimimi, punësimi dhe trajnimi profesional; c) përdorimi ose jo i alkoolit dhe i substancave narkotike; ç) kushtet fizike dhe psikologjike; d) motivimi për kryerjen e veprës/veprave penale dhe qëndrimi i tij ndaj veprës penale. I gjithë informacioni që grumbullohet në këto seksione të veçanta, përpunohet më pas, për të dalë në një përfundim të përgjithshëm mbi shkallën e rrezikshmërisë së shkelësit dhe prirjet e tij për t'u ripërfshirë në sjellje kriminale⁷⁴. Ndërkohë për vlerësimin e rrezikut të arratisjes nga burgu merren parasysh tentativa të mëparshme, si dhe prania e karakteristikave të veçanta në personalitetin e të dënuarit.
- Sistemi i vlerësimit të rrezikshmërisë së të dënuarve, për nga vetë natyra e çështjeve që përfshin, do të ishte mirë që të administrohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me struktura të tjera profesionale, të cilat mund të angazhoheshin në një platformë të përbashkët bashkëpunimi në bazën e marrëveshjeve me ministrinë e linjës, si Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo Ministria e Shëndetësisë, si dhe me OJF që ofrojnë shërbime të tilla.
- Në rastet e vendosjes nga ana e gjykatës të dënimit me burgim, sistemi i vlerësimit të rrezikshmërisë paraqet një mekanizëm tepër të rëndësishëm për përcaktimin e llojit të IEVP-së ku i dënuari do të vuajë dënimin. Kjo ndihmon në një shpërndarje më të drejtë dhe efikase të të dënuarve në institucione me nivele të ndryshme sigurie, sipas rrezikshmërisë reale që paraqet secili i dënuar.
- Sipas kuadrit ligjor aktual, mbi bazën e vendimit të gjykatës dhe kriterëve të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, gjykata përcakton llojin e institucionit ku i dënuari do të vuajë dënimin⁷⁵. Për shkak

73 P.sh. në Britaninë e Madhe prej vitit 2001 ka filluar të funksionojë Sistemi i Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të dënuarve i njohur ndryshe si OASys. Ky është një proces i standardizuar për vlerësimin e shkelësve, i zhvilluar në mënyrë të përbashkët nga Shërbimi i Provës dhe Administrata e Burgjeve. Nëpërmjet një përqsajeje të strukturuar, ky sistem synon të vlerësojë prirjet e shkelësit për t'u ripërfshirë në sjellje kriminale, faktorët kriminogjenë që e shtynë atë në sjellje deviante, dhe rrezikshmërinë që paraqet secili shkelës. Sistemi administrohet në mënyrë periodike dhe vlerësimet rishikohen zakonisht çdo katër, gjashtë ose 12 muaj. Shih: Soothill, K., Rogers, P., dhe Dolan, M. *Handbook of Forensic Mental Health*. Willian Publishing, 2008, f. 206.

74 Konkretisht çdo seksion i raportit vlerësohet me pikë, të cilat më pas mbliidhen në total dhe rezultati përdoret si referim për të kryer kategorizimin e shkelësit.

75 Shih nenin 22 të Ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 ‘Për ekzekutimin e vendimeve penale’, i ndryshuar.

të mungesës së mekanizmave të përshtatshëm vlerësues, marrja e vendimit për IEVP-në ku do të vendoset i dënuari nuk paraprihet nga një studim i plotë i personalitetit të autorit të veprës penale. Parimi i administrimit të drejtë të drejtësisë penale kërkon që caktimi i regjimit të vuajtjes së dënimit me burgim t'i përgjigjet shkallës reale të rrezikshmërisë që paraqet i dënuari. Interesat e drejtësisë dhe të drejtat e personit të dënuar do të garantoheshin më mirë nëse caktimi i IEVP-së ku do të vuajë dënimin personi i dënuar bëhet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë midis Gjykatës, Prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës. Kjo ndihmon gjithashtu në një shpërndarje më të drejtë të të dënuarve në sistemin penitenciar dhe ndikon në përmirësimin e situatës së mbipopullimit brenda institucioneve të veçanta të vuajtjes së dënimit.

- Ndërtimi i mekanizmave të vlerësimit dhe menaxhimit të riskut do të ishte në linjë edhe me kërkesat e Rekomandimit CM/Rec (2014)3 të Këshillit të Evropës 'Mbi shkelësit e rrezikshëm'⁷⁶, ku shprehet qartë rëndësia që kanë këto mekanizma për adresimin e saktë nga organet e drejtësisë penale të kësaj kategorie shkelësish dhe trajtimin e mëtejshëm të tyre. Krahas njohjes së rëndësisë së instrumenteve të vlerësimit të rrezikut të shkelësve të rrezikshëm⁷⁷, në këtë rekomandim u kushtohet vëmendje e veçantë edhe instrumenteve të menaxhimit të rrezikut. Menaxhimi i rrezikut përshkruhet si procesi i përzgjedhjes dhe zbatimit të një sërë masash ndërhyrëse në vendet e vuajtjes së dënimit ose në qendrat komunitare, me qëllim zvogëlimin e rrezikut për kryerjen e krimeve të rënda nga shkelësit e cilësuar si të rrezikshëm.
- Programet e menaxhimit të rrezikut duhet të lehtësojnë komunikimin efektiv, dhe të mbështesin bashkëpunimin e gjithanshëm midis administratës së burgjeve, punonjësve të shërbimit të provës, shërbimeve sociale dhe mjekësore dhe agjencive ligjzbatuese⁷⁸.
- Vlen të theksojmë se procesi i vlerësimit të rrezikut të shkelësve duhet të projektohet si një proces i vazhdueshëm, i cili nuk mbaron pas caktimit nga gjykata/prokurori të institucionit të burgut ku do të akomodohet i dënuari. Vlerësimi i të dënuarve bëhet në baza periodike, pasi gjatë ecurisë së vuajtjes së dënimit, faktorë të caktuar kriminogjenë mund të pushojnë së vepruari ose e kundërta, mund të shfaqen faktorë të rinj; si rezultat, rrezikshmëria që paraqet i dënuari mund të mos i përgjigjet më parametrave të sigurisë të institucionit ku është duke vuajtur aktualisht dënimin. Kështu, rrethanat

76 Recommendation CM/Rec(2014)3 of the Committee of Ministers to member States concerning dangerous offenders. <https://wcd.coe.int>

77 *Vlerësimi i rrezikut* përcaktohet si një proces që konsiston në vlerësimin e natyrës dhe rrezikshmërisë së shkeljes, karakteristikave të autorit të veprës dhe rrethanave që e shtynë në kryerjen e saj, me qëllim marrjen e vendimeve të duhura që kanë në fokus zvogëlimin e rrezikut.

Ndërkohë, një *shkelës i rrezikshëm* përcaktohet si një person, i cili është dënuar për një krim të rëndë seksual ose një krim të rëndë të dhunshëm kundër personave dhe që ka shumë mundësi të kryejë sërish një vepër penale të së njëjtës natyre.

78 Recommendation CM/Rec(2014)3 of the Committee of Ministers to member States concerning dangerous offenders. <https://wcd.coe.int>

mund të kërkojnë që një i dënuar të transferohet nga një burg i sigurisë së lartë në një burg të një shkalle sigurie më të ulët ose anasjelltas.

- Zbatimi efektiv i sistemit të menaxhimit të vazhdueshëm të rrezikut nënkupton gjithashtu edhe hartimin e programeve të masave të veçanta të orientuara drejt një përmirësimi gradual të të dënuarve, me qëllim uljen e rrezikshmërisë së tyre. Për këtë kërkohej një koordinim dhe bashkëpunim midis agjencive të ndryshme në ofrimin e asistencës dhe shërbimeve të veçanta që lehtësojnë rehabilitimin e tyre.

5. Në lidhje me zbatimin e masës së mjekimit të detyruar në një institucion mjekësor

- Aktualisht, në I EVP Krujë janë vendosur 117 persona me çrregullime të shëndetit mendor⁷⁹, për të cilët gjykata ka caktuar masën e mjekimit të detyruar. Ndërkohë që rreth 290 persona të dënuar ose të paraburgosur me probleme të shëndetit mendor janë të vendosur në spitalin e burgut. Në raportin e tij më të fundit, KShH ka theksuar se situata e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me masa mjekësore në një institucion psikiatrik të parashikuar nga neni 46 i Kodit penal, vazhdon të zbatohet në kundërshtim me ligjin pavarësisht se është një shqetësim i vazhdueshëm që nga viti 1997⁸⁰.
- Seksioni i veçantë për të sëmurët mendorë brenda I EVP Krujë nuk plotëson parametrat e një institucioni mjekësor ku të sëmurët mendorë mund të marrin shërbim shëndetësor të përshtatshëm në përputhje me nevojat specifike. Kjo bie ndesh me parashikimin e nenit 46 të Kodit Penal ku thuhet **‘se masa mjekësore konsiston në vendosjen e personave të papërgjegjshëm në një institucion mjekësor’**.
- Për më tepër, mbajtja e tyre në një I EVP, edhe pse në një seksion të veçantë, bie ndesh me detyrimet e vendosura nga Konventa e OKB-së *‘Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’*, për një trajtim jo diskriminues të tyre⁸¹. Në nenin 5 të emërtuar *‘Barazia dhe mosdiskriminimi’* thuhet se *‘me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimin e diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për të siguruar se është ofruar akomodim i arsyeshëm’*. Akomodimi i të sëmurve mendorë në ambientet e një I EVP-je përbën një formë trajtimi diskriminues pasi shërbimet që u ofrohen në këto ambiente nuk përmbushin në mënyrë të kënaqshme nevojat e tyre për kujdes të veçantë mjekësor. Praktika e mbajtjes së të dënuarve

79 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Të dhëna statistikore – gusht 2015

80 ‘Raport studimor për vendimet e prokurorisë për mosfillimin dhe pushimin e procedimeve penale dhe procedurat për ekzekutimin e vendimeve penale’, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014. f. 80. <http://ahc.org.al/>, aksesuar 26 shtator 2015.

81 Konventa është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012 *‘Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’*, dhe është tashmë pjesë e sistemit të brendshëm juridik. Si rrjedhim, shteti shqiptar duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e detyrimeve të Konventës.

me probleme të shëndetit mendor brenda sistemit penitenciar bie ndesh gjithashtu me ndalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues sipas nenit 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

- Mes studiuesve shprehet mendimi se mbyllja e të dënuarve me probleme të shëndetit mendor në institucione të veçanta brenda sistemit penitenciar, përbën dhunim të rëndë të të drejtave të tyre, pasi në një farë mënyre i vendos ata në një formë të përjetshme të privimit të lirisë⁸². Kjo pasi, gjendja e papërgjegjshmërisë mendore tek të sëmurët mendorë kronikë mund të zgjasë gjatë gjithë jetës së tyre, dhe si rrjedhim, edhe izolimi në institucione të veçanta do të ishte i përjetshëm.

Rekomandime

- Nevojitet një ndërhyrje sa më e shpejtë për t'i kaluar personat e papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale nga sistemi penitenciar nën kujdesin dhe vëmendjen e strukturave të shëndetësisë dhe përkujdesjes sociale.
Për më tepër, kalimi i kësaj kategorie shkelësish në varësi të Ministrisë së Drejtësisë është në të njëjtën linjë me propozimet e bëra nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për Reformën në Drejtësi⁸³.
- Një zgjidhje e përshtatshme për ofrimin e shërbimit të nevojshëm shëndetësor ndaj këtyre personave do të ishte ngritja e qendrave të trajtimit psikiatrik ligjor (*Forensic Psychiatric Centers*), si struktura në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Këto qendra do të funksiononin si njësi të veçanta për ofrimin e programeve gjithëpërfshirëse të vlerësimit, trajtimit dhe rehabilitimit të të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor.
- Për të siguruar një trajtim sa më kompetent dhe sa më afër nevojave të të sëmurëve mendorë programet e ofruara në këto qendra duhet të fokusohen në dy linja kryesore veprimi: a) ofrimi i ndihmës së specializuar mjekësore dhe klinike dhe; b) ofrimi i trajtimeve me bazë komunitare që mundësojnë vendosjen e tyre të monitoruar në mjedise gjysmë të hapura.

82 Albrecht, H.J. Plenary speech – Punimet e Konferencës së dytë vjetore të Max Planck Partner Group on Balkan Criminology, *‘Imprisonment in the Balkans’*, 17-19 shtator 2015, Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë.

83 Për më tepër shih: “Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, qershor, 2015, f. 173. Burimi: <http://shqiptarja.com/>.

6. Në lidhje me zbatimin e instrumenteve të drejtësisë restauruese**Konkluzione**

- Zbatimi i drejtësisë restauruese në çështjet penale mbetet i ulët. Këtu kemi parasysh nocionin e drejtësisë restauruese si një proces që mbledh së bashku të gjitha palët e prekura nga dëmi i shkaktuar nga vepra e paligjshme, si p.sh. shkelësit dhe familjet e tyre, viktimat dhe familjet e tyre, përfaqësues të komunitetit dhe të agjencive shtetërore (p.sh. policia)⁸⁴. Këto subjekte hyjnë në bisedime për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për rikuperimin e dëmit të shkaktuar. Edhe pse kuadri ligjor që rregullon ndërmjetësimin në çështjet penale⁸⁵ është në fuqi prej disa vitesh, numri i rasteve të zgjidhura me ndërmjetësim vazhdon të jetë i ulët.
- Perceptimi mbizotërues për veprat penale është se ato kryhen kundër shtetit dhe se dhunojnë normat dominuese në shoqëri. Rëndësi primare i kushtohet dëmit që shkakton shkelja e normave penale për shoqërinë në tërësi, dhe jo interesave private të individëve apo të një komuniteti të vogël, që mund të preken nga akti i paligjshëm. Kjo e bën të vështirë zbatimin me efikasitet të mekanizmave ndërmjetësues duke qenë se në vlerësimin e pasojës së ardhur nga vepra penale, nuk i kushtohet rëndësia e duhur interesave të viktimës apo të palëve të treta të prekura në një çështje penale.

Rekomandime

- Politikëbërësit duhet të marrin seriozisht në konsideratë rolin e drejtësisë restauruese në çështjet penale, dhe ndikimin që ndërmjetësimi mund të ketë në menaxhimin e problemit të mbipopullimit të burgjeve. Është koha për të menduar për një zhvendosje të fokusit të sistemit të drejtësisë penale nga disa sjellje kriminale më pak të dëmshme, dhe që një pjesë e konflikteve në komunitet apo mes subjekteve private të zgjidhen nëpërmjet mekanizmave ndërmjetësues.
- Për të zgjeruar zbatimin e ndërmjetësimit në çështjet penale, është e nevojshme të rritet ndërgjegjësimi, qoftë i institucioneve shtetërore ose i palëve private, në lidhje me rrethanat e përdorimit dhe zbatimin efektiv të instrumenteve të drejtësisë restauruese. Në këtë kuptim, ekspertët shprehën se është e nevojshme që përpjekjet të përqendrohen në aktivitete të vazhdueshme trajnuese të niveleve të ndryshme, për praktikues të ligjit, si: gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, punonjës socialë apo të organizatave joqeveritare, si dhe të ndërmerren fushata promovuese drejt publikut të gjerë⁸⁶.

84 Shih: Braithwaite, J., & Strang, H. (2001). *Restorative Justice and Civil Society*. Cambridge: Cambridge University Press

85 Rregullimi bëhet me ligjin nr. 10385, datë 24.2.2011 "Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve".

86 Shih : *Restorative Justice and Crime Prevention: Presenting a theoretical exploration, an empirical analysis and the policy perspective*. (2015, f. 181). Final report of the European project 'Restorative Justice and Crime Prevention'. Department of Juvenile Justice-Italian Ministry of Justice, [23.02.2015].

- Mbetet e nevojshme që në ligjin e posaçëm të zgjerohet rrethi i çështjeve që zgjidhen me ndërmjetësim. P.sh. shkelje të tilla, si drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, largimi nga vendi i aksidentit etj., mund të parashikohen si raste që mund të zgjidhen me ndërmjetësim⁸⁷.
- Duhet të punohet më shumë për të shtuar përdorimin e drejtësisë restauruese për veprat penale të kryera nga të miturit.

7. Në lidhje me ristrukturimin e sistemit penitenciar

Konkluzione

- Ligji nr. 40/2014⁸⁸ ka sjellë zhvillime pozitive për sa i përket garantimit të standardeve më të larta të trajtimit të të dënuarve në përputhje me rekomandimet e Komunitetit Evropian.
Megjithatë, mendojmë se duhet parë me rezervë alternativa e hapjes së IEVP-ve private. Kalimi i disa burgjeve në pronësi të subjekteve private, të cilët për nga vetë kushtet ekonomike ku veprojnë janë të orientuar në mënyrë parësore drejt fitimit, mund të kishte një efekt përshkallëzues në rritjen e popullsisë së burgjeve. Në vlerësimin e hapjes së këtyre institucioneve duhet marrë në konsideratë rreziku i depersonalizimit të të dënuarve dhe vlerësimi i tyre si subjekte të përfitimit ekonomik, gjë që mund të rriste shtysat drejt një politike penale akoma më ndëshkuese.
- Sfidues paraqitet gjithashtu ndërtimi i një strukture kompakte të bashkëpunimit dhe llogaridhënies midis aktorëve publikë dhe privatë për vënien në funksionim të skemave të IEVP-ve private.

Rekomandime

- *Ngritja e burgjeve me regjim të hapur*
Ngritja e burgjeve të hapura do të ndihmonte në lehtësimin e situatës së mbipopullimit të burgjeve, pasi ambientet e brendshme të institucionit do të përdroreshin vetëm si ambiente fjetjeje. Kjo rrit mundësitë për të përballuar një kapacitet më të lartë të burgosurish brenda të njëjtës hapësirë fizike. Në këto burgje, të dënuarit lëvizin lirisht brenda hapësirës së burgut, duke mos qenë të kufizuar në qeli, ndërkohë që gjatë natës sistemohen në dhoma të përbashkëta fjetjeje nën monitorimin e stafit të burgut.
- *Ngritja e këtyre burgjeve do të krijonte infrastrukturën e nevojshme edhe për*

⁸⁷ Në Itali këto shkelje parashikohen si raste që mund të zgjidhen me ndërmjetësim. Shih : Nenin 4, pika q), të Dekretit Legjislativ nr. 274, datë 28.08.2000 “Disposizioni sulla competenza penale del giudice di pace, a norma dell’articolo 14 della legge 24 novembre 1999, n. 468”, si dhe nenet 186, 187, 189 të Dekretit Legjislativ nr.285, datë 30 prill 1992, n. 285 “Nuovo codice della strada”.

⁸⁸ Ligji nr. 40/2014 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8328, dt16.4.1998, “për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve

zbatimin e dënimit alternativ të gjysmëlisë, i cili në kushtet aktuale për shkak të mungesës së institucioneve të përshtatshme dhe burimeve të kufizuara njerëzore, mbetet i paaplikueshëm.

- Ngritja e institucioneve të hapura të vuajtjes së dënimit përbën gjithashtu një zgjidhje të përshtatshme për vendosjen e shkelësve të mitur që janë pa familje (jetimë), apo që kanë një historik dhune në familjet e tyre, dhe si rezultat, nuk janë në gjendje për të pasur një kontroll efektiv apo të shëndoshë nga ana e familjes.

Ngritja e qendrave të pritjes

- Këto qendra do të shërbenin në radhë të parë si pika ndalimi, ose për ofrimin e shërbimeve dhe programeve bazë për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, si dhe për drejtimin në programe dhe shërbime të lidhura drejtpërdrejt me nevojat e tyre.
- Së dyti këto qendra do të shërbenin për plotësimin e detyrimeve nga të dënuarit e vënë në provë apo ata të vendosur në gjysmëlisi.
- Programet e ofruara në këto qendra përmbajnë një grup aktivitetesh të detyrueshme dhe vullnetare (seanca rehabilitimi) për të dënuarit, dhe për secilin aktivitet caktohen objektivat që duhen përmbushur.
- Kjo do të krijonte infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e programeve me bazë komunitare, lehtëson procesin e riintegrit të të dënuarve në shoqëri dhe promovon sjelljen e përgjegjshme mes tyre.

8. Në lidhje me zbatimin e masave të sigurimit mbi lirinë personale

- Përpjekje akoma më bindëse duhet të bëhen për një përjasje më të ngushtë të prokurorëve dhe gjyqtarëve ndaj masave të sigurimit mbi lirinë personale. Rikujtojmë se në Rekomandimin nr. R(99)22 të Komitetit të Ministrave të BE-së, është theksuar se 'Caktimi i masës së sigurisë së arrestit në burg duhet të shihet si masa e fundit për t'u marrë, veçanërisht kur rëndësia e krimit, do e bënte të papërshtatshme në mënyrë të dukshme çdo masë tjetër'⁸⁹.
- Është e nevojshme të ndryshojë praktika e ndeshur kohët e fundit, e caktimit të masës së sigurisë të 'arrestit në burg' për vepra penale me rrezikshmëri të ulët, si p.sh. drejtimi i automjetit në gjendje të dehur apo pa dëshmi, apo vjedhje në vlera të vogla materiale.
- Në këtë kuptim, merr rëndësi të madhe siguri i trajnimit të përshtatshëm të punonjësve të agjencive ligjzbatuese mbi rrethanat e zbatimit të masës së

⁸⁹ Shih: Recommendation No. R(99) 22 of the The Committee of Ministers of Council of Europe 'concerning prison overcrowding and prison population inflation' (para 1), <http://pjp-eu.coe.int/>, aksesuar 1 korrik 2015.

arrestit në burg, çka do të shërbente gjithashtu për të shmangur situatat e shkeljes së të drejtave të njeriut si rrjedhojë e zbatimit jo të duhur të dispozitave ligjore.

- Rekomandohet të trajtohet çështja e përdorimit të tepruar të paraburgimit, i cili nuk duhet të përdoret si masë standarde.
- Rekomandohet përmirësimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë për të përsheptuar gjykimet dhe për të reduktuar periudhën e paraburgimit për të ndaluarit, sidomos për të miturit, duke parandaluar në këtë mënyrë ndalimin arbitrar.

9. *Në lidhje me adresimin e recidivizmit*

- Duhet marrë masa të rëndësishme institucionale dhe operacionale për të mbështetur ri-integrimin e ish-të dënuarve në shoqëri për të ulur normat e recidivizmit. Për shkak të viteve të izolimit, ish-të dënuarit janë më të prirur për të përjetuar shqetësime psikologjike në rivendosjen e kontakteve me botën e jashtme dhe adaptimit me jetën në shoqëri. Gjithashtu, stigmatizimi, perspektivat pesimiste në lidhje me punësimin dhe të ardhurat e ulëta mund të rrisin më tej nivelin e stresit tek këta persona, dhe të bëhen një shtysë e fuqishme drejt ripërfshirjes në krim.
- Për këtë qëllim, është e nevojshme të promovohen programe të mbështetjes të ish-të dënuarve me asistencën e nevojshme teknike dhe profesionale për të kapërcyer pengesat e mundshme gjatë riintegrit në shoqëri.
- Gjithashtu, rekomandohet krijimi i një mjedisi miqësor bashkëpunimi me agjenci dhe organizma lokale për të lehtësuar punësimin e ish të dënuarve, dhe nëse është e mundur, të ofrohen edhe stimuj financiarë për ata punëdhënës që punësojnë një ish të dënuar.

Referenca:

Libra dhe Artikuj

Aebi, M.F., Linde, A., dhe Delgrande, N. Is There a Relationship Between Imprisonment and Crime in Western Europe?. *European Journal of Criminal Policy and Research*, 2015, fq. 1-22.

Albrecht, H.J. (2015). Criminal Sanctions and Crime Control: Past, Presence and Future in Europe. Libri i punimeve të simpoziumit shkencor 'Criminal Justice System and the Social Welfare', Tiranë: Shtypshkronja 'Mileniumi i Ri'.

Braithwaite, J., & Strang, H. (2001). *Restorative Justice and Civil Society*. Cambridge: Cambridge University Press.

Brym, R. J., dhe Lie, J. *Sociology: Pop Culture to Social Structure*, Belmont: Wadsworth Cengage Learning, 2013, f. 117; si dhe Shahidullah, SH.M. *Crime Policy in America: Law, Institutions and Programs*. Lanham, University Press of America, 2008.

Clarke, R.V. Situational Prevention, Criminology and Social Values., in Von Hirsch, A., Garland, D., & Wakefield, A. (2000). *Ethical and Social Perspectives on Situational Crime Prevention*. Portland: Hart Publishing.

D.A. Andrews and James Bonta, *The Psychology of Criminal Conduct* (Oxon: Routledge, 2015).

Erebara, Gj. (2015). *Albania Ombudsman Slams Jail Overcrowding*. <http://www.balkaninsight.com/> [10 qershor 2015].

Gaines, L.K., dhe Mille, R.L. *Criminal Justice in Action: The Core*. 8th edition. Boston: Cengage Learning. 2013, fq. 134-168.

Joan Petersilia and Kevin R. Reitz, *The Oxford Handbook of Sentencing and Corrections* (Oxford: Oxford University Press, 2012).

Lynch, J., dhe Sabol, W. (2010). Prisoner Reentry in Perspective', cituar nga Siegel, L. *Criminology*. 2012, f. 128, Belmont: Wadsworth, Cengage Learning.

Marion Vacharet, *Private Family Visits in Canada, Between Rehabilitation and Stricter Control: Portrait of a System*, <https://champpenal.revues.org/2322> [28 maj 2015].

Moore, L. D., dhe Elkavich, A. (2008). Who's using and who's doing time: Incarceration, thewaron drugs,and public health. *American Journal of Public Health*, 98(5), 782-786, cituar në: Brym, R. J., dhe Lie, J. *Sociology: Pop Culture to Social Structure*, Belmont: Wadsworth Cengage Learning, 2013.

Paula Smith, M.A. Claire Goggin, and M.A. Paul Gendreau, *The Effects of Prison Sentences and Intermediate Sanctions on Recidivism: General Effects and Individual Differences* (2002).

Philip Feldman, *The Psychology of Crime: A Social Science Textbook*, (Cambridge: Cambridge University Press, 1993).

Robert.M Freeman, *Correctional Organization and Management. Public Policy Challenges, Behavior, and Structure* (Woburn: Butterworth-Heinemann,1999).

Roberts, A.R., & Springer, D.W. (2007). *Social Work in Juvenile and Criminal Justice Settings, 3rd edition*. Springfield: Charles C Thomas Publisher.

Roesch, R., Zapf, P., dhe Hart, S.D. *Forensic Psychology and Law*. Hoboken: John Wiley & Sons, 2010.

Smith, P., Goggin, C., dhe Gendreau, P. *The Effects of Prison Sentences and Intermediate Sanctions on Recidivism: General Effects and Individual Differences* (2002), <https://www.publicsafety.gc.ca/cnt/rsrscs/pblctns/ffcts-prsn-sntncls/ffcts-prsn-sntncls-eng.pdf> [15.06. 2013].

Soothill, K., Rogers, P., dhe Dolan, M. *Handbook of Forensic Mental Health*. Willian Publishing, 2008.

Sunčica Vujić, *Econometric studies to the economic and social factors of crime*, (Tinbergen Institute research series, no.454, 2009).

The Effects of Prison Overcrowding. John Howard Society of Alberta (1996). <http://www.johnhoward.ab.ca/pub/C42.htm> [20 Qershor 2015].

Dokumente, Raporte, Rekomandime

«Raport mbi Situatën e të Drejtave të Njeriut të Personave të Privuar nga Liria në Drejtoritë dhe Komisaritet e Policisë dhe Institucionet e Paraburgimit dhe të Ekzekutimit të Vendimeve Penale», Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Tiranë 2014.

'OSCE media freedom representative, on official visit to Denmark, urges for full decriminalization of defamation, blasphemy' <http://www.osce.org/fom/108769>, [1 korrik 2015].

Aktiviteti i Avokatit të Popullit të Shqipërisë në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Raporti i Posaçëm, 2014.

Analizë vjetore e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, 2013.

Dokumenti «*Fact Finding for Institutional Self Assessment, Sector: Fundamental Rights, Penitentiary System*», f. 1., Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, 2015

Komentari i Rregullit 18 të Rregullave Evropiane të Burgjeve (European Prison Rules).

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, «Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri», qershor, 2015. Burimi: <http://shqiptarja.com/>.

Prison Overcrowding and Prison Population Inflation: Recommendation No. R (99) 22, Adopted by the Committee of Ministers of the Council of Europe on 30 September 1999 and Report. (Council of Europe Pub., 2000).

Raport i Avokatit të Popullit, dt. 06.01.2015, Mbi situatën e mbipopullimit në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Raportet e Prokurorit të Përgjithshëm për gjendjen e kriminalitetit në Shqipëri për vitet 2012, 2013. <http://www.pp.gov.al/>

Raporti i studimit të fizibilitetit për programin e reformës në sektorin e drejtësisë në Shqipëri, përgatitur nga Grupi i Punës i Zinxhirit të Drejtësisë (Policia Suedeze, Autoriteti Suedezi i Prokurorisë, Administrata Suedeze e Gjykatave Kombëtare dhe Shërbimi Suedezi i Burgjeve dhe Provës), 2015.

Recommendation CM/Rec(2014)3 of the Committee of Ministers to member States concerning dangerous offenders. <https://wcd.coe.int>

Recommendation No. R(99) 2 of the The Committee of Ministers of Council of Europe 'concerning prison overcrowding and prison population inflation', (para. 22), <http://pjp-eu.coe.int/>, aksesuar 1 korrik 2015.

Rekomandime për Prokurorin e Përgjithshëm 'Në luftën kundër Kriminalitetit për vitin 2015'. Ministria e Drejtësisë <http://www.drejtesia.gov.al/>

Restorative Justice and Crime Prevention: Presenting a theoretical exploration, an empirical analysis and the policy perspective. (2015, f. 181). Final report of the European project 'Restorative Justice and Crime Prevention'. Department of Juvenile Justice-Italian Ministry of Justice, [23.02.2015].

United Nations Office on Drugs And Crime (2013). *Custodial and Non-Custodial Measures: The Prison System*, http://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/cjat_eng/1_Prison_%20System.pdf, aksesuar 30 qershor 2015.

United Nations Office on Drugs And Crime (2013). Handbook on strategies to reduce overcrowding in prisons overcrowding in prisons. *Foreword by the International Committee of the Red Cross (ICRC)*, <http://www.unodc.org/> [20 maj 2015].

United Nations Office on Drugs And Crime, *Custodial and Non-Custodial Measures, Social Reintegration*, (2006),1, <https://www.unodc.org> 23 qershor 2015.

Legjislacioni

Ligji nr.7895 datë:27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr. 144/2013 «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895 datë:27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr.7905 datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”

Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve ” i ndryshuar

Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale ” i ndryshuar

Ligj nr.10 494, dt. 22.12.2011 “Për mbikëqyrjen elektronike të personave, të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor”.

Ligj nr. 44/2012 «Për Shëndetin Mendor»

Ligji nr. 10385, datë 24.2.2011 “Për Ndërmjetësimin në Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve”.

Ligj nr. 108/2012 ‘Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara’

